



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 04.10. 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 24.09.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe KfW Frankfurt Am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektvendimi/Kërkesë “Për një shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. Projektvendimi “Për disa ndryshime të strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”- (3 kërkesa) *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Projektvendimi/Kërkesë “Për shtesë të numrit të punonjësve dhe riklasifikim të pagave të administratës së institucionit të Komisionerëve Publikë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

8. Projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtarë të Bordit të Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

9. Projektvendimi “Për miratimin e procedurës paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

10. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” *(Neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” *(neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)*

11. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës *(neni 45 i Rregullores)*

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futet media!

Fillojmë seancën plenare të ditës së sotme.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Lidhur me procesverbalin e seancës së kaluar, a ka ndonjë vërejtje? Nuk ka.

(Deputeti Braçe flet nga salla)

Urdhëro? Po.

Erion Braçe – I nderuar Kryetar,

Prej pesë javësh i kam adresuar Kuvendit një kërkesë për interpelancë me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë.

Në nenin 80 të Kushtetutës është e përcaktuar qartë: “Kryeministri dhe ministri, thirrur në interpelancë nga një deputet apo nga një grup deputetësh, janë të detyruar të përgjigjen brenda tri javësh në sallën e Kuvendit.”

Kanë kaluar dy të enjte, por ministri i Financave dhe i Ekonomisë nuk është paraqitur ende në interpelancë, për një çështje shumë konkrete dhe shumë të qartë për të, por mbi të gjitha me interes publik për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Po e përsëris: është neni 80 i Kushtetutës. Nuk është pika 80 e dëshirave të mia, por është neni 80 i Kushtetutës, ai që e sanksionon këtë.

Për këtë interpelancë, unë dhe ministri i Financave dhe i Ekonomisë kemi gjashtë muaj që komunikojmë zyrtarisht, me shkresa. Në qoftë se unë e kam seriozisht një çështje të caktuar, më lejoni t’ju them se përgjigjet që kam marrë, në cilësinë e deputetit, nga germa e parë deri te germa e fundit janë tallje Luli pikërisht me interesin publik dhe me interesin tim si deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Bëhet fjalë për ligjshmërinë fiskale të një institucioni të caktuar, për barazinë fiskale të atij institucioni, që është në thelb të pabarazisë, që, më lejoni t’ju vë në dukje, konsumohet përditë në këtë vend.

Kësisoj, do t’ju lutesha shumë që javën e ardhshme, meqë kjo ditë po mbaron, të planifikohet interpelanca ime me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë në lidhje me çështjen e ligjshmërisë fiskale dhe barazisë fiskale në Federatën Shqiptare të Futbollit, për individë, për organizatën, si dhe për detyrimet që përcakton ligji për sportin, që duhej të ishin arkëtuar në buxhetin e shtetit këtu e dhjetë vjet më parë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, keni të drejtë. Është e vërtetë që ka kaluar trejavëshi që përcakton Rregullorja. Sigurisht, administrata e Kuvendit ka komunikuar me ministrin. Ju e dini që ministri ka qenë një javë me shërbim jashtë shtetit për të ndjekur problemet e eurobondit. Është kthyer mbrëmë. Është komunikuar me të jashtë shtetit, ka kërkuar një kohë, dhe me siguri do të jetë disponibël për javën tjetër, zoti Braçe, për të realizuar kërkesën tuaj për interpelancë.

Për miratimin e procesverbalit nuk ka vërejtje.

Njoftime: në Kuvend janë depozituar shtatë projektligje, pesë ratifikime nga Këshilli i Ministrave, ndërsa dy nisma janë të deputetit Braçe. Titujt e tyre i keni përpara, në tavolinë. Si gjithmonë, materialet do t’i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit, në internet, si dhe në sistemin online të parlamentit.

Fillojmë me projektligjin e radhës “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””.

Në qoftë se nismëtari ka diçka... Nuk ka. Po nga komisioni përkatës? Pyetje nuk ka. Për këtë projektligj janë regjistruar deputetët: Blerina Gjylameti, Elisa Spiropali, Evis Kushi, dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, deputeti Ervin Bushati.

Fjalën e ka zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi në fund të vitit të parë të mandatit tonë të dytë dhe, ashtu sikundër e kemi thënë shpesh, efektet e reformave që bëjnë në mandatin e parë po japin rezultate të dukshme.

Tashmë ekonomia shqiptare ka marrë një certifikatë në tregjet ndërkombëtare botërore, duke mirëpritur emetimin e eurobondit. Kjo tregon se reformat e kësaj qeverie janë më se të mirëpritura, ashtu sikundër e kanë deklaruar edhe mjaft institucione ndërkombëtare.

Vetëm opozita në Shqipëri, e cila edhe sot mungon këtu, ku duhet të jetë për të përfaqësuar më së miri interesat e atyre që e kanë votuar, nuk ka sy të shohë se çfarë është bërë në këto vite, pas një shkatërrimi total të ekonomisë dhe të financave, pas një shkatërrimit total që i bëri buxhetit të shtetit.

Nuk ka qenë e lehtë të ndërmerreshin këto reforma gjatë këtyre viteve, e mbi të gjitha jo me pak kosto, por ajo që mund të themi është: ishin të domosdoshme. Ka shumë rëndësi, dhe duhet të mendojmë vazhdimisht, se të gjitha këto ishin të nevojshme pikërisht për ta rikthyer edhe një herë ekonominë shqiptare në shinat e ligjshmërisë e të konsolidimit fiskal, si dhe për të rikthyer vëmendjen maksimale të atyre që na kanë votuar.

Jam e bindur se të gjithë na kanë mirëkuptuar, pavarësisht kostos, sepse sot reformat që janë ndërmarrë përkthehen si sukses, mbi të gjitha, për qytetarët shqiptarë.

Sigurisht, nuk mund të themi se e kemi bërë mjaftueshmërisht mirë punën tonë, dhe se me kaq jemi të mrekulluar. Mbetet ende shumë për të bërë, pasi pritshmëritë e qytetarëve ndaj nesh janë të mëdha, gjë që e dimë. Për asnjë moment nuk duhet ta humbasim besimin që ata na dhanë në qershorin e 2017-ës. Asnjë kategori nuk është përjashtuar, dhe më vjen shumë mirë që flas sot për këto vendime, pasi kemi arritur ta mbajmë fjalën e dhënë para qytetarëve. Do ta nisim me një lajm shumë të mirë për pjesën e një ekonomie me baza më të forta, që na lejon sot të kemi një vëmendje të shtuar ndaj rritjes së pagave dhe të pensioneve. Do të ketë rritje pagash për mësuesit, për mjekët, për ushtarakët. Kemi ndryshuar taksën, nga një taksë e sheshtë në një taksë progresive për të gjithë ata që fitonin më pak.

Nëpërmjet kësaj reforme kemi mundësuar heqjen e shumës prej 57, 3 miliardë lekësh nga buxheti i shtetit drejt xhepave të qytetarëve, të atyre qytetarëve që kanë besuar dhe vazhdojnë të besojnë në përgjegjshmërinë e kësaj qeverie. 97, 3 % e të gjithë atyre që punojnë në shtet apo në privat përfituan nga taksimi i ndershëm. Do të kemi lehtësime të rëndësishme taksash për një pjesë të konsiderueshme dhe shumë aktive të biznesit, pra për biznesin e vogël, që arrin deri në 140 milionë xhiro në vit.

Të nderuar kolegë,

Nuk besoj se ka pasur një projekt tjetër më të rëndësishëm që i ka shënuar gjithë këtë 5-vjeçar të qeverisjes sonë, sa rikthimi i vëmendjes tek njerëzit. Politikat e ndërmarra prej nesh në këto vite të qeverisjes, ndonëse kanë qenë tepër të vështira për shkak të gjendjes në të cilën e gjetëm ekonominë shqiptare, por edhe për shkak

të klimës ndërkombëtare të ekonomisë, kanë dhënë një impakt pozitiv e të drejtpërdrejtë të qytetarët e thjeshtë.

Pavarësisht përbaltjes së opozitës, vëmendja jonë qëndron te njerëzit, tek të cilët jo vetëm që ka sjellë një rritje të qëndrueshme të ekonomisë, por edhe një ndikim tek ata që kanë qenë e janë më vulnerabël. Këto vite është bërë e mundur edhe një rritje e pagave të të gjithë kategorive të punonjësve të sektorit shtetëror, por edhe të atyre privat. Është rritur gjithashtu ndihma për shtresat në nevojë dhe për ato kategori që kanë pasur më shumë nevojë për mbështetje.

Po çfarë bëri opozita, e cila, në fakt, nuk ka arritur të kuptojë gjë as nga mësimet e së kaluarës, sikurse ishin edhe leksionet që i dhanë qytetarët në zgjedhjet e viteve 2013, 2015, 2017. Përveç përbaltjes, mos ofruan ata ndonjë alternativë apo ndonjë nismë, e cila do të vendoste në qendër qytetarët dhe jo zgjidhjen apo mbrojtjen e interesave të familjarëve dhe të klientëve në bizneset e tyre? Jo.

Teksa udhëton për pushime nga njëri qytet në tjetrin, duke shijuar edhe projektet tona të rilindjes urbane, të cilat kanë sjellë një transformim të jetës edhe në rrethe, lideri i opozitës shfaqet si i shqetësuar në kamera; pikërisht ai, të cilin, kur kishte pasur mundësi reale të bënte diçka për njerëzit, e pati zënë gjumi.

Pak ditë më parë Kryeministri njoftoi një politikë të re sociale, çekun e bebes, risi të cilën për herë të parë e ka shpallur vetë zoti Rama në kohën kur ishte kryetar i Bashkisë së Tiranës. Tashmë është një mundësi më e madhe për ta kthyer edhe një herë vëmendjen ndaj nevojave të qytetarëve, por mbi të gjitha ndaj rritjes së popullsisë.

A nuk ishte Lulzim Basha ai i cili, me të ardhur në Bashkinë e Tiranës përmes vjedhjes së hapur të votave, një nga vendimet e para që mori ishte pikërisht heqja e këtij çeku? Ndërsa vendimi i dytë që mori në Bashkinë e Tiranës, sapo erdhi në bashki, qe heqja e bursës për nxënësit me rezultate të shkëlqyera. U hoqi nxënësve pikërisht atë mbështetjen minimale që kishin.

Mjaftojnë pikërisht këto dy vendimet e para të drejtuesit aktual të opozitës për të kuptuar konceptin e tij për punën e për drejtimin, por më

shumë sa i përket vëmendjes së munguar ndaj atyre për të cilët thërret e bërtet çdo ditë se është shumë i shqetësuar.

Të nderuar kolegë,

Projektligji që kemi sot për diskutim shtyn afatin për të gjitha ato investime strategjike, të cilat kanë pasur dhe kanë mbështetjen me qëllimin e vetëm për të pasur një ekonomi më të qëndrueshme, për të pasur një ekonomi të konsoliduar, e cila përkthehet ekzaktësisht në më shumë vende pune, përkthehet ekzaktësisht në më shumë mirëqenie dhe në më shumë të ardhura për qytetarët. Falë administrimit të të ardhurave dhe politikave të kujdesshme të ndërmarra nga qeveria, tashmë kemi rikthyer jo vetëm dinjitetin e punonjësve të administratës, por janë bërë përpjekje serioze për të pasur një rritje ekonomike të qëndrueshme.

Ne kemi pasur rritje pagash në arsim, në shëndetësi dhe rritje pagash për punonjësit e policisë. Kësaj radhe, duke pasur suksese në reforma të ndërmarra më parë, bëhet e mundur rritja e pagave edhe për një sektor tjetër, siç është ai i ushtrisë, i cili nuk e ka pasur këtë rritje me parë.

Unë dhe kolegët e mi jemi të gjithë koshtientë se ka ende shumë për të bërë dhe mbi të gjitha shumë për të përmirësuar, nuk mund të pretendojmë se çdo gjë duhet të bëhet me shkopin magjik, por duhet të bëhen me përgjegjësi maksimale dhe me një qasje, e cila duhet të jetë drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm. Është shumë e rëndësishme dhe nuk duhet të harrojmë edhe kontekstin në të cilin veprojmë, mbi të gjitha për sa i përket një sektori tjetër, sikurse është edhe biznesi i vogël, për të cilin janë krijuar një sërë lehtësira për t'i mbështetur, sidomos pjesën e vetëpunësimit.

Suksesi i reformave, por edhe i ekonomisë kanë bërë që të kemi një vlerësim të ekonomisë sonë nga institucione të rëndësishme ndërkombëtare. Ishin tregjet ato që testuan dhe vlerësuan qasjen e ekonomisë shqiptare, reformat e rëndësishme dhe të domosdoshme, për të cilat tashmë janë duke na shpërblyer. Shqipëria është bërë tashmë një vend ku mund të investohet pa frikë dhe në periudhë afatgjatë. Eurobondi është një tjetër lajm i mirë për ekonominë shqiptare, pasi mundëson një hapësirë shumë më të madhe për të gjitha bizneset, të cilat operojnë në Shqipëri që të kenë akses më të madh në pjesën e

kreditimit. Ndërkohë, ne ulim koston për shkak edhe të përqindjes më të ulët, por mbi të gjitha pasi jemi më të besueshëm në konsolidimin e ekonomisë sonë.

Të nderuar kolegë, pa dashur ta zgjas fjalën time, ju ftoj ta votojmë atë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fjala është për zonjën Kushi.

Evis Kushi - I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Unë sot dua të diskutoj për një problem që ditët e fundit është kthyer në një shqetësim serioz jo vetëm për ne deputetët dhe qytetarët e Elbasanit, por edhe për mbarë opinionin publik, sepse, fatkeqësisht, pati aq shumë ndikime politike, gënjeshtra dhe manipulime, saqë problemi për të cilin po diskutoj në fund fare u transformua në një pseudokauzë e një partie opozitare, që vazhdon të jetë çdo ditë në kërkim të një kauze të vërtetë.

Është fjala për shkollën 9-vjeçare të fshatit Mengël të Elbasanit, e cila u mbyll për shkak të dëmtimeve të tërmetit të ndodhur një vit më parë. Kjo e detyroi bashkinë që nga njëra anë për të mos e ndërprerë procesin mësimor dhe nga ana tjetër për të garantuar jetën e nxënësve t'i dërgonte ata përkohësisht në shkollat e qytetit, me një distancë vetëm 2 kilometra larg, duke garantuar edhe transportin falas.

Deri këtu banorët e zonës kanë të gjithë të drejtën e tyre që të jenë edhe të pakënaqur me këtë situatë, pse jo edhe të protestojnë për ndonjë vonesë apo zvarritje të punës për rikonstruksionin e shkollës. Në fund të fundit, protestat janë një mjet i funksionimit të demokracisë dhe na ndihmojnë të gjithëve për të reflektuar më mirë dhe në kohën e duhur.

Ne vërtet mund të jemi të vonuar në trajtimin e kësaj çështjeje, pra është që ta fillojmë përgjegjësinë nga vetja, nga Drejtoria Arsimore, bashkia, apo qoftë edhe ministria, nëse ka pasur informacion dhe nuk ka marrë masa, aq më shumë ne deputetët që nuk e kemi ngritur zërin më fort dhe më herët.

Ne mund të kemi bërë shumë gabime, por nuk i kemi përdorur asnjëherë fëmijët si mish për top në betejat tona politike. Është krejt e paimagjinueshme dhe e papranueshme të arrish

deri aty sa të bësh politikë duke vënë në rrezik edhe jetën e fëmijëve, siç ka bërë opozita jonë e dëshpëruar gjatë këtyre ditëve.

Më vjen shumë keq që sot ata nuk janë këtu në këtë sallë që të përballim argumentet tona. Pastaj janë qytetarët që na gjykojnë dhe na vlerësojnë. Por ndoshta është më mirë për ta, sepse nuk e di se si do të justifikoheshin sot, që i kanë nxjerrë fëmijët në rrugë për të protestuar, i kanë nxitur të hyjnë me forcë në ambientet e shkollës së dëmtuar, i kanë përballur me forcat e policisë, të cilët janë detyruar të shkojnë atje për të mos lejuar askënd të hyjë brenda, për të shmangur çdo lloj tragjedie.

Të nderuar kolegë, po sikur të shembej godina, kush do të mbante përgjegjësi për katastrofën?!

Specialistët me anë të një analize dhe ekspertize të hollësishme kanë konstatuar tundjet e soletës kur fëmijët ecin dhe vrapojnë, çarjen e mureve, rënien e suvatimeve, fundosjen e dyshemesë dhe gropa në të. Rrjedhimisht e kanë vlerësuar si të papërshtatshme për të funksionuar dhe me rrezik serioz për nxënësit. Cilin duhet të besojmë? Ekspertët, inxhinierët, arkitektët, apo deputetët e zonës?

Dua të sqaroj se Bashkia e Elbasanit ka kërkuar rikonstruksionin total të godinës, duke shtuar edhe klasa për shkak të numrit të madh të nxënësve, duke kërkuar të vendosë edhe sistemin e ngrohjes me të gjithë parametrat e kërkuar për një shkollë të standardeve normale. Kjo pa dyshim kërkon më shumë kohë dhe mjete financiare. Prandaj, në kushtet e emergjencës bashkia vendosi për një rikonstruksion të pjesshëm. Menjëherë pas këtij vendimi u zhvilluan procedurat e detyrueshme ligjore të prokurimit publik dhe dje kanë filluar punimet për përforcimin e trarëve dhe të strukturës mbajtëse, të cilat do të zgjasin vetëm dy javë dhe në mes të tetorit shkolla do të jetë gati për të pritur nxënësit. Por kjo nuk e anashkalon projektin për rikonstruksionin total të shkollës, pasi ashtu si të gjithë fëmijët, edhe fëmijët e Mengëlit meritojnë të mësojnë në kushtet më të mira dhe me standarde njësoj si shkollat e qytetit.

Theksoj se ky vendim u mor në datën 20 shtator të vitit 2018, pak ditë më parë nga këshilli bashkiak i Elbasanit, në unanimitet të plotë. Pra, nuk kanë votuar vetëm këshilltarët e

majtë, por edhe këshilltarët e PD-së, këshilltarët e LSI-së, edhe këshilltarët e PDIU-së. Të gjithë bashkë kanë votuar në unanimitet për këtë zgjidhje.

Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë që opozita fillimisht në mënyrë të logjikshme bashkohet me vendimin e duhur në interes të nxënësve dhe të banorëve, por pastaj kujtohet që nuk e shfrytëzoi siç duhet këtë shqetësim dhe hajde le ta kthejmë në kauzë! Të nxisim pakënaqësitë, t'i mashtrojmë banorët, se këta duan ta shesin shkollën, t'i ngremë fëmijët nëpër protesta që të bllokojmë rrugët nacionale, t'i përleshim me policinë e të tjera si këto, si dhe skena të shëmtuara dhune me pretendimin se qeveria po mbyll shkollën dhe po i lë fëmijët pa arsimim.

Tashmë situata është shumë e qartë që e vërteta është krejt ndryshe. Unë nuk dua të merrem më me opozitën, sepse është zgjedhja e saj nëse vendos ta bëjë betejën e saj mbështetur në mashtrime apo në të vërteta, por nga kjo foltore në mbyllje të fjalës sime, dua t'u bëj thirrje të gjithë banorëve të zonës së Mengëlit që të tregohen të duruar, të mos influencohen nga ata që duan t'i shfrytëzojnë për qëllimet e tyre. Siguria dhe jeta e fëmijëve është shumë më e rëndësishme se interesat e ngushta politike të një partie opozitare, siç e thashë pak më lart të dëshpëruar.

Në fund fare, unë u bëj thirrje kolegëve të opozitës që nuk janë në sallë që pas dy javësh, kur shkolla të jetë gati, të shkojmë të gjithë bashkë, të gjithë deputetët, të majtë dhe të djathtë t'i mirëpresim nxënësit dhe t'u urojmë suksese!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zonja Kushi dhe koleget që e duartrokitën! Por do t'ju tërheq vëmendjen se ky problem mund të shtrohej në diskutimet jashtë rendit të ditës, në 5 - minutëshin e vendosur dhe jo në diskutimet për investimet strategjike. Të mos abuzojmë me fjalën dhe mos më detyroni që t'jua ndërpres fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është investim strategjik dhe nuk ka lidhje fare me ligjin. Mund të shfrytëzonit 5-minutëshin.

Fjala është për ministrin e Financave dhe të Ekonomisë, zotin Ahmetaj.

Arben Ahmetaj – Përsëritet të gjithë grupin parlamentar për mbështetjen që i bëri

procesit tejet delikat të emetimit të eurobondit në tregjet ndërkombëtare, atë që qeveria e kishte si planifikim strategjik për të zbutur, mitiguar të gjitha rrisqet që mund t'i dilnin ekonomisë shqiptare, menaxhimit të borxhit publik në vitin 2020 dhe përtej.

Ligji në fjalë na jep një mundësi shumë të mirë për të bërë një rezymë të të gjithë asaj që kemi kaluar dhe të gjithë asaj që kemi përpara. Pse po e ndryshojmë ligjin “Për investimet strategjike”? A ka funksionuar ky ligj, apo jo? Çfarë presim në lidhje me legjislacionin në mbështetje të investimeve të huaja, në veçanti dhe të investimeve publike apo atyre private në tërësi?

Ligji u aprovua në vitin 2015 nga maxhoranca dhe sot gjithkush nga ne mund ta thotë fare kollaj se investimet e huaja private kanë ardhur vetëm në rritje. Vetëm në 6-mujorin e parë të vitit 2018 rritjen e investimeve të huaja e kemi 28%. E mbani mend diskutimin se dy projekte të mëdha, duke mbaruar fazën e tyre të investimit do të krijonin probleme në llogarinë e investimeve të huaja? Fakti sot është tjetër, investimet në tërësi dhe ato të huaja kanë kontribuar drejtpërsëdrejti në ekonominë dhe në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Ka ndryshuar tregu i punës. Shumëkush nga ju sot mund ta marrë si të garantuar atë që është dhe atë që shikon, por a e mbani mend fjalën e Kryeministrit, kur tha: “Mbrapa kemi një gropë dhe para kemi një shkëmb”. Sot gropa është në distancë mbrapa dhe shkëmbi është thërrmuar. Shumëkush nga qytetarët apo edhe nga opozita e munguar mund të vijë dhe të thotë: “Pse Shqipëria është vend rozë? Shqipëria sot nuk ka probleme ekonomike?”. Përkundrazi, Shqipëria ka pafundësisht probleme ekonomike, sociale dhe financiare, por nuk e ka më gropën afër dhe nuk e ka më shkëmbin përballë.

Ajo që ndodhi në tregjet ndërkombëtare pardje është fakt i gjallë, i vërtetë përtej çdo lloji emocioni blu apo i çdo lloji ngjyre tjetër, si test i ekonomisë shqiptare. Çfarë bënë tregjet financiare me ekonominë e vendit? E futën në skaner dhe pranuan të investojnë te siguria e Shqipërisë me një kupon 7-vjeçar afatgjatë me nivel 3,5%. A e dini sa larg kemi qenë nga rajoni? Ndërkohë që Maqedonia e ka borxhin 45%, Mali i Zi 55% të GDP-së, ne e kemi sot 67,5 në rënie. Përpara disa vjetësh jo që nuk na

trajtonin një lloj me rajonin, por na shikonin me dyshim edhe te 5-vjeçari. Nëse e mbani mend, në vitin 2010 interesi doli 7,5 % dhe në një moment u tregtuan në tregjet ndërkombëtare 13%. Çfarë do të thotë kjo për qytetarët? Ky vend atë vit nuk quhej vend normal. Në vitin 2010 ishte vendi ku nuk qëndronte dot në të dyja këmbët, atë vit ky vend nuk ishte një vend ku mund të investohej. 13%, kush i paguan? Qytetarët i paguan. Çfarë ndodhi sot? Sot tregjet ndërkombëtare e financuan me 3,5 % kuponin tonë për 7 vjet, jo më për 5. E dini çfarë do të thotë për 7 vjet? Që ata investitorë (do t'ju numëroj edhe investitorët) ulen në tryezat e tyre dhe me flohtësi gjykojnë se kjo ekonomi e ka të qartë rrugën përpara, i ka të qarta reformat, sepse reformat ishin ato që e bënë të mundur që vendi të bëhej i sigurt për të investuar. Ka edhe një element tjetër? A e dini bazën e investitorëve? Ishin 123 investitorë, afërsisht që morën pjesë në kërkesat për blerjen e eurobondit shqiptar, nga të cilët emrat më të mëdhenj të financave ndërkombëtare, që nga “Goldman Sachs”, që nga “J.P Morgan” që nga “PIMCO” dhe, po të doni ta dini, për herë të parë kanë marrë pjesë edhe fonde pensionesh nga Finlanda, si dhe nga fondi i pensioneve të shoqërisë së hekurudhave të Francës. A e kuptoni se çfarë ka ndodhur me vendin?! Nuk është puna se kush e bleu bonon tonë, por se sa besim kanë; nuk është puna se çfarë bëmë ne në menaxhimin e borxhit, sepse e kemi për detyrë ta bëjmë, por vendi ynë referohet si vend normal dhe do të merret edhe si referencë për investitorët e huaj. Ky është thelbi.

Për sa i përket ligjit, dua t'ju sqaroj se ai është një ndryshim logjistik kohor, sepse ne jemi duke përgatitur, së bashku me IFC-në dhe jo vetëm, një ligj integral për investimet e huaja, ku do t'i trajtojmë në parim, me transparencë dhe barazi investimet e huaja në Shqipëri.

Së fundi, dua ta mbyll fjalën time duke ju kujtuar juve që jeni këtu, por edhe qytetarëve se ekonomia e Shqipërisë ka për të kaluar ende teste. Mos harroni që vendet e rajonit, po të doni edhe të gjithë partnerët tanë tregtarë të mëdhenj, si Italia, kanë problematika të mëdha. Në qoftë se nuk do të kishim bërë reformat, duke filluar që nga energjia, pensionet, makroekonomia, fisku, reforma territoriale dhe në drejtësi, këto problematika do të na kishin prekur edhe ne. Jo

vetëm që kemi qenë imunitë ndaj të gjitha problematikave, të cilat mund të na shkaktonin një krizë ose ngadalësim në ekonominë e Shqipërisë, por po rritemi me 4,3%. Çdokush mund të thotë “Me 4,5% mburreni?!” Nuk po mburremi, por po ju them se e nisëm nga 0 dhe shkuam në 4,3%.

Sfida ka pa fund, por ajo që dua të theksoj është se për shkak të reformave po vijnë në tryezë, një muaj para buxhetit, paketa që nuk ishin menduar kurrë, siç është bonusi i bebeve, i cili shkon në drejtimin e duhur për të ndihmuar rritjen demografike të Shqipërisë; paketa e rritjes së pagave për infermierët, për ushtarakët, për mjekët dhe për arsimin; paketa e solidaritetit për pensionistët, e cila bëri të mundur që fondi i pensionit të rritet me 5%; librat falas, ku 190 mijë nxënës shkojnë çdo ditë në shkollë me libra falas; 600 mijë të pasiguruar, që përfitojnë rimbursim ilaçesh, të lënë dje në mes të rrugës dhe shumë paketa sociale të tjera, të cilat janë bërë të mundura vetëm për shkak të reformave, e asaj që kemi bërë këta 4 vjet dhe do të vazhdojmë të bëjmë në vitet që vijnë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjala për zonjën Sonila Qato.

Sonila Qato - I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë ministra dhe deputetë,

Historia e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë në 3 dekadat e fundit deri në vitin 2013 tregoi se qeverisjet e mëparshme kishin një mungesë vizioni të theksuar në raport me përzgjedhjen e një modeli ekonomik, i cili do të garantonte një zhvillim të qëndrueshëm, afatgjatë dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve. Ky ishte shkak i krijimit të një vakumi të theksuar strukturor në ekonominë e vendit, me të cilin u përballëm në vitin 2013, pasojat e së cilës ekonomia shqiptare i vuan edhe sot.

Për 27 vjet sektorët jetikë të ekonomisë u panë thjesht dhe vetëm si hambarë votash, ku investimet sporadike kanë krijuar vazhdimisht iluzione të një bumi ekonomik, por që janë venitur shpejt, duke lënë pas një hendek të thelluar jo vetëm në raport me avantazhet konkurruese, por edhe me ato krahasuese.

Sot për herë të parë, pas 27 vjetësh, po qasemi me shpejtësi drejt një realiteti të ri dhe kjo falë reformave dhe vizionit të kësaj qeverie, e cila kishte guximin t'i thoshte stop këtij modeli të mbrapshtë, duke hedhur themelet e para të një ekonomie moderne të mbështetur fort në sektorët e saj strategjikë.

Përgatitja dhe miratimi i kuadrit ligjor për investimet strategjike në vitin 2015 ishte vetëm hapi i parë i një politike të re, e cila po garanton jo vetëm një rritje të shpejtë ekonomike, por edhe të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Falë reformave të ndërmarra nga qeveria përgjatë këtyre viteve, Shqipëria është sot vendi me rritjen ekonomike më të shpejtë në rajon, rritje që prodhon më shumë punë dhe, pa dyshim, më shumë investime strategjike në çdo sektor të ekonomisë.

Sot Shqipëria ka një klimë më të shëndoshë për thithjen e investimeve të huaja dhe këtë e dëshmojnë edhe flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte në Shqipëri, që gjatë muajve të parë të vitit 2018 kanë pësuar një rritje vjetore mbi 50%.

Turizmi, bujqësia, sektori energjetik, manufaktura dhe infrastruktura, falë bashkëpunimit publik-privat, po krijojnë modele suksesi, të cilat po zhvillohen dhe do të zhvillohen me shpejtësi, duke garantuar punësim dhe më shumë të ardhura për çdo shqiptar.

Kolegët opozitarë, në kohën kur qeverisnin, trumbetonin për turizëm gjithëvjetor në një kohë kur vendin e kishin zhytur në borxhe të pafundme dhe duke nisur ato pak rrugë 10 vjet më parë, duke lënë pas një faturë të kripur, të likuiduar me borxhe dhe plotësisht të pajustifikuar. Ata e trumbetonin Shqipërinë si një superfuqi energjetike në rajon, duke firmosur qindra kontrata koncesionare, pjesa kryesore e të cilave konsumoi me sukses vetëm fazën e parë të implementimit të tyre, atë të shpyllëzimit masiv të sipërfaqeve pyjore të marra në përdorim, pa prodhuar as edhe një kilovat të vetëm apo ndonjë ndikim në ekonomi. Po njësoj trumbetonin dështimet e tyre në çdo sektor tjetër strategjik, duke thelluar çdo ditë e më shumë distancën me trajektoren e zhvillimit të qëndrueshëm.

Sot kemi investime në sektorin energjetik, minerar dhe të hidrokarbureve, me emra globalë si: SHELL, TAP dhe kompani të tjera, që kanë

dhënë kontribut të rëndësishëm në ekonominë shqiptare, por edhe në punësim. Investitorë të ndryshëm kanë shprehur interes në një sërë sektorësh, që për ne janë strategjike dhe përkrahen si: turizmi, ICT, bujqësia dhe infrastruktura. Mbi të gjitha, kemi krijuar avantazhe dhe lehtësi të mëdha në aspektin e politikave fiskale dhe përmirësimit të shërbimeve publike, me të cilat përballet çdo sipërmarrës apo investitor shqiptar.

Sot Shqipëria ka institucionalizuar një sërë mekanizmash mbrojtës për investitorët dhe për çdo sipërmarrës, të cilët kanë investuar kapitale në vendin tonë, rol ky që ndiqet nga zyra që drejtojnë dhe që ka fokus të veçantë çdo nevojë, kërkesë, ankesë apo sugjerim të ardhur nga përfaqësuesit e investitorëve strategjike në Shqipëri, të cilët përkrahen, falë këtyre politikave, në çdo problematikë që ata hasin.

Falë një dialogu të ngritur tashmë me sipërmarrjen, si dhe falë kontributit të çmuar të tyre, dhjetëra procedura administrative janë lehtësuar nga barra 27-vjeçare e burokracisë, duke përshtatur dhe promovuar fort ofrimin e një numri të madh shërbimesh publike, që sot ofrohen nga platforma e-Albania, me qëllim jo vetëm deburokratizimin e sistemit administrativ, por, mbi të gjitha, rritjen e transparencës, luftës kundër korrupsionit në gjirin e administratës publike dhe ofrimin e një shërbimi cilësor dhe në kohë reale.

Ne jemi në konsultë të përhershme me të gjitha grupet e interesit apo përfaqësuesit e sipërmarrëseve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sipërmarrja po jep kontributin e saj në përmirësimin e kuadrit ligjor për investimet, kryesisht në katër pilarë të rëndësishëm për nxitjen e investimeve në vend si: ligji “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”; ligji “Për partneritetin publik privat”; ligji “Për turizmin” dhe ligji “Për investimet strategjike”. Ky kuadër duhet të jetë sa më motivues dhe lehtësisht i zbatueshëm, i aftë për të mbajtur investimet ekzistuese dhe për të nxitur investimet e reja, po ashtu sikurse duhet të jetë i aftë të harmonizohet me konkluzionet e axhendës rajonale për investimet, axhendë e cila hap tregun e Shqipërisë me tregun rajonal.

Të nderuar, jemi të bindur se kuadri ligjor për investime ka një rëndësi thelbësore për sa u

përket garancive, transparencës dhe parashikueshmërisë për investitorët strategjike në Shqipëri dhe se zbatimi i tij do të vazhdojë të përmbushë qëllimet ambicioze të kësaj qeverie, për rritjen e ekonomisë së vendit dhe përmirësimin e dukshëm të klimës së biznesit në Shqipëri, bazuar në garantimin e qëndrueshmërisë së kuadrit ligjor, si kusht për investime të mëdha dhe të sigurta për çdo investitor potencial.

Të vetëdijshëm për hendekun e madh të trashëguar, ne zgjodhëm rrugën e gjatë, por të sigurt, duke krijuar ndoshta edhe pakënaqësi momentale, por kjo ishte rruga e duhur që përmirësoi dita-ditës një model zhvillimor të qëndrueshëm dhe me terma afatgjatë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr zonja Vasilika Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Qato!

Fjalën e ka kërkuar ministrja, zonja Kumbaro.

Të përgatitet deputetja Elisa Spiropali.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, çështja në rendin e ditës ka të bëjë me investimet strategjike. Pikërisht, për këtë jam e bindur se është momenti i duhur për të folur për kulturën, si një sektor strategjik, siç nuk është kuptuar dhe trajtuar më parë. Nëse nuk është kuptuar qartë se çdo investim për kulturën, është investim për mirëqenien e sotme dhe për stabilitetin e së ardhmes, atëherë realisht kemi një problem me emancipimin e shoqërisë. Qoftë edhe për këtë, është detyrë qytetare të flasim për të dhe detyrë politike dhe publike të këmbëngulim që investimet në kulturë të konsiderohen strategjike, sepse e gjithë vëmendja jonë është te njerëzit dhe tek e ardhmja e tyre. Të tillë e kemi gjykuar kulturën kur kemi vendosur, kemi punuar dhe kemi realizuar që për 4 vjet të investonim dhe të hapnim 4 muze të reja me standarde europiane, që janë krenari kombëtare dhe pasaporta jonë më e mirë. Edhe Muzeu Historik Kombëtar, i hapur që në vitin 1982, deri më vitin 2013 nuk kishte parë asnjë investim me sy. Prandaj, tashmë kemi nisur punën për dy projekte të rëndësishme: përgatitjen e projektit për rehabilitimin e Muzeut Historik Kombëtar dhe përgatitjen e projektit për rehabilitimin e Muzeut Kombëtar të Arteve të

Bukura ose, siç njihet ndryshe, Galeria Kombëtare e Arteve.

Kulturën e konsiderojmë strategjike, prandaj kemi hapur jo pak kantiere teatrore: në Korçë e rindërtuam teatrin nga e para; në Shkodër restauruam dhe rinovuam teatrin “Migjeni”; në Tiranë tashmë kemi hapur dhe kemi inauguruar një institucion të ri të artit skenik, që është plot çdo natë; gëlon puna në kantierin e Teatrit të Operës dhe Baletit; po rikonstruktohet teatri në Fier; u rikonstruktua i plotë amfiteatri veror te Liqeni Artificial dhe nuk do të ndalemi. Teatri Kombëtar, dhe jo vetëm, do të jetë kantieri i ardhshëm. Këto nuk janë fasada, janë respekt për artistët, janë vëmendje për kushtet e tyre të punës, janë nevojë e shoqërisë për të siguruar akses dhe shërbime për publikun. Në fakt, janë detyrë politike për të garantuar edukim dhe kulturim për shoqërinë.

Të nderuar kolegë, nuk ka investim më të rëndësishëm se ai për emancipimin e shoqërisë. Më besoni, këtë nuk e them si ministre, e them si nënë, e them si pedagoge, si mësuese që, për 30 vjet punë në auditorët e universiteteve, kam parë tragjikisht të bjerë niveli i dijes, niveli kulturor dhe niveli i ndërgjegjes kulturore të brezave. Prandaj rikthimi i publikut në kulturë, në teatër, në muze është detyra jonë, është emergjencë kombëtare. Kjo nuk bëhet as me një vit dhe as me një mandat, por ka gjithmonë një ndërgjegjësim të politikës për këtë gjë. Prandaj e gjithë vëmendja jonë është kthyer te kultura dhe tek trashëgimia kulturore për të forcuar identitetin tonë kulturor, ndërgjegjen tonë kulturore, si përkatësi europiane, por, edhe sepse sot jemi më shumë se kurrë dëshmitarë të rëndësisë që luan ky sektor në ekonomi dhe në turizëm.

Këtë vit 20% e vizitorëve në këtë sezon ishin mirëfilli turistë kulturorë. A e dini sa ka qenë numri i vizitorëve në kalanë e Gjirokastrës në vitin 2013?! 6 mijë e 900 vizitorë. Pra, 96 mijë vizitorë u shënuan deri më 30 shtator të këtij viti në këtë kala. Meqenëse po flasim për Gjirokastrën, dua të them dy fjalë, sepse sapo inauguruam rilindjen e zemrës së qendrës historike të Gjirokastrës. Një punë 3-vjeçare që ia vlente t’i hynim, jo t’i hynim detit në këmbë, por t’i hynim Gjirokastrës nën lëkurë, domethënë, nën gurë, sepse lëkura e gurtë e Gjirokastrës ka duruar shekuj, por nuk mund dhe

nuk duhet t’ia fshehim vetes se në tri dekadat e fundit dhe pak më shumë ia kanë bërë plagë lëkurën Gjirokastrës. E kishin parë, por e kishin lënë t’i plasaritej, t’i çahet, t’i rridhte gjak, madje edhe t’i mahisej, derisa t’i bëhej gangrenë. Kjo do të thotë që keni humbur. Si guxojnë të flasin sot ata, që nuk i lanë kusur Gjirokastrës dhe e lanë në atë derexhe?! Gjithsesi, nuk do të merrem me ta. Vëmendja ime, vëmendja jonë është te kultura, te njerëzit e kulturës, te Gjirokastra dhe gjirokastritët, të cilët bënë sa mundëm, me ç’të mundnin, por shumë herë nuk mundën të bënin gjë fare, sepse u gjendën vetëm. Kjo ishte Gjirokastra që gjetëm, me faqen copë-copë, me zemrën e qendrës historike të sflitur. Ajo Gjirokastra nikoqire nuk kishte as tri hotele në të gjithë qytetin dhe kishte vetëm një restorant e gjysmë. Dhe ku?! Në Gjirokastrë, ku është e sigurt se fitohen të gjitha konkuret për nikoqiret.

Si ministre e Kulturës, e gjitha kjo më është dukur e frikshme katër vjet më parë. Si gjirokastrite më dhembte në shpirt, në rrënjë, por jo vetëm mua, por të gjithë skuadrës sonë qeverisëse. Prandaj nuk kishim asnjë dilemë se Gjirokastra ishte dhe mbetet një prioritet. Besoj se kemi qenë shumë të qartë për këtë projekt, me të cilin do t’i kthejmë Gjirokastrës vëmendjen e munguar dhe të merituar.

Ku jemi sot?! Nëse futeni në faqen e njohur ndërkombëtarisht “*booking.com*”, janë 91 oferta akomodimi për në Gjirokastrë. Kjo ka ndodhur në më pak se 4 vjet. Vetëm në Qafën e Pazarit janë investuar tre milionë dollarë bashkë me partnerët tanë strategjikë, siç është Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ku u restauruan mbi 5 mijë metra katrorë, të cilat, në fakt, janë prona të rivlerësuar të gjirokastritëve.

Nuk do të ndalemi. Kështu, sapo kemi nisur po në Gjirokastrë fazën e dytë të restaurimeve prej 10 milionë dollarësh me një partner tjetër, me Bankën Botërore. Bashkë me Beratin, Sarandën, Përmetin marrëveshja me Bankën Botërore shkon në 71 milionë dollarë për turizmin e trashëgimisë kulturore. Në fakt, kjo ndodh, sepse jemi të besueshëm në projektet tona, sepse e konsiderojmë kulturën si një investim strategjik në kuptimin bashkëkohor. Pikërisht për këtë në katër vjetët e fundit, 2014-2018, investimet nga partnerët tanë

ndërkombëtarë janë dy herë më shumë sesa është buxheti i investimeve publike në kulturë.

Në 8 vjet, nga 2005-2013, kur ministria i kishte të gjitha bashkë, kulturën, sportin dhe turizmin, janë investuar 21 milionë euro, por zor se thotë dot njeri se çfarë ka mbetur. Të paktën në kujtesë nuk na ka mbetur gjë. 19 milionë euro kemi investuar në katër vjet nga buxheti i shtetit dhe 23 milionë euro janë nga donatorët dhe partnerët tanë ndërkombëtarë vetëm në qendrat historike, në parqe arkeologjike, në restaurimet në muze, teatro dhe jo vetëm. Pra, janë investuar mbi 40 milionë euro nga Shkodra në Sarandë.

Kam edhe një lajm tjetër që dua ta ndaj me ju. Dje nisi puna për një kantier të ri të trashëgimisë kulturore jo vetëm shqiptare, por botërore. Nisëm punën për planin e integruar të menaxhimit të Parkut Arkeologjik të Butrintit. Një vit më parë nuk u la gjë pa thënë edhe në këtë sallë, ku jemi sot. Nga 1 janari deri më 30 shtator Butrinti ka pasur rreth 200 mijë vizitorë. Vetëm ata që e anatemuam nuk e kanë vizituar. Vetëm nëse e kanë vizituar fshehurazi. Dhe e uroj këtë gjë. E uroj me gjithë zemër dhe ju them: hallall! Nuk ka problem, sepse ka rëndësi që ta kenë shijuar. Të gjithë ata që e vizituan janë mrekulluar nga bukuria e natyrës, nga shërbimi në park, nga vizitat dhe nga trashëgimia kulturore dhe nga fakti se sa mirë e kemi ruajtur ne.

Brenda vitit tjetër do të jemi sërish bashkë këtu në këtë sallë për t'iu prezantuar produktin më të rëndësishëm të ligjit të ri për trashëgiminë dhe muzetë, të cilin e miratuar bashkë dhe që ka të bëjë pikërisht, ndër të tjera, edhe me menaxhimin e pasurive kulturore, konkretisht me Butrintin; puna për të u bë dje konkrete dhe do të nisë nesër.

Natyrisht, nuk mund ta mbyll fjalën time pa përmendur Teatrin. Falënderoj këdo që erdhi në Teatër javën që shkoi dhe pa se si Teatri Kombëtar organizoi Festivalin Mbarëkombëtar Teatror, i cili u rikthye pas 20 vjetësh. Nga 14 trupat teatrale, që morën pjesë anëmbanë trojeve shqiptare, çmimin për shfaqjen më të mirë e mori Teatri Shqiptar i Shkupit, sepse ne po ndërtojmë teatrin e të gjithë shqiptarëve. Në fakt, Art-Turbina, institucioni më i ri skenik, gëlon çdo natë me shfaqje të të gjitha gjinive, sepse, në fakt, teatri janë artistët dhe publiku në sallë.

Ejani nesër sërish në Teatër, sepse do të kemi një premierë të re. Është shfaqja e regjisorit Gëzim Kame, e cila titullohet "Terror". Mos kini frikë se teatër është!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Këtu mbyllet lista e diskutantëve të regjistruar.

Kalojmë në shprehjen në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka deputeti Ervin Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Shqipëria sot është shumë më e besueshme se tre vjet më parë apo se tetë vjet më parë përballë partnerëve tanë strategjikë, të cilët janë krah për krah nesh për të ndihmuar dhe për të përkrahur ekonominë shqiptare.

Dje në festën e ribashkimit të Republikës Federale të Gjermanisë e falënderuam qeverinë gjermane për investimin e saj strategjik, si mike e Shqipërisë, 1 miliard euro gjatë gjithë këtyre viteve që ka qenë pranë nesh. Këto 1 miliard euro janë investuar në sektorët kyçë strategjikë të Shqipërisë. Gjithmonë e gjejmë kohën për t'i falënderuar, sepse jemi mirënjohës ndaj partnerëve tanë strategjikë, të cilët kanë bërë kaq shumë për këtë vend, për qytetarët e tij dhe jo për qeveritë apo për politikën.

Në mjedis janë investuar 47, 9 milionë euro, ku kanë përfutur 655 mijë shqiptarë.

Në ujësjellës-kanalizime është investuar një shifër rekord prej 392 milionë eurosh, ku kanë përfutur 1,3 milionë njerëz.

Për të ndihmuar ekonominë, bizneset dhe sipërmarrjen shqiptare janë investuar 171 milionë euro, ku kanë përfutur 200 mijë biznese shqiptare. Kjo tregon që miqtë tanë, tregjet ndërkombëtare kanë një besueshmëri në rritje drejt Shqipërisë. Shqipëria me hapa të sigurt dhe të matur është sot në tregjet ndërkombëtare dhe për parterët strategjikë është një vend ku ia vlen të investohet.

Ajo që ka ndodhur para pak ditësh, që është vlerësimi, nota më e saktë që merr një vend në tregjet ndërkombëtare kur del në treg të hapur, ka qenë një histori suksesi, sepse sot jemi mesatarisht 2 herë (më saktë, 214%) më të

besuar se në vitin 2010, kur eurobondi shqiptar doli në tregjet ndërkombëtare.

Gjithashtu, (se është gjithmonë kjo historia “të mos matem me vitin 1938, të mos matem me kohën e Saliut të Dytë”), edhe në krahasim me vitin 2015, përsëri kemi një përmirësim prej 64%. Pra, 3,5% është interesi i eurobondit, për një periudhë 7-vjeçare, 500 milionë euro, në krahasim me 5,75% që ishte në vitin 2015 nga qeveria e parë “Rama”.

Por çfarë do të thotë kjo për qytetarët? Këto shifra, patjetër, janë të rëndësishme për ekonomistët, janë të rëndësishme për financat publike, por përkthehen edhe në përfitime për qytetarët shqiptarë.

Në radhë të parë, ajo që kursehet nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, që do të shkonin vetëm interesa për të paguar borxhet, është 20 milionë euro në vit, jo 20 milionë euro në 8 vjet dhe ne do të paguanim më shumë në qoftë se interesi do të ishte njësoj si në kohën e Saliut të Dytë. Në krahasim me 2015-n, sot paguajmë 11,25 milionë euro më pak. Pra, këto para sot janë marrë me terma shumë më favorizuese.

Sot, Shqipëria performon në skenën financiare ndërkombëtare në nivele besueshmërie njësoj me ekonomitë shumë më të stabilizuara se jona, si ekonomia italiane dhe greke, si dhe më mirë se të gjitha ekonomitë e rajonit.

Në radhë të parë këtu ndikon stabiliteti politik. Kemi një maxhorancë që me një parti mund të miratojë të gjitha reformat, të cilat i ka në programin e saj elektorale, pa pasur nevojë për t'i ridimensionuar, për t'i shtyrë, për t'i transformuar vetëm në bazë të orekseve politike, por të shkojë përpara dhe t'i bëjë reformat. Reformat si: në energji, reforma territoriale, reforma në financat publike, reforma në arsimin e lartë dhe, së fundi, reforma në drejtësi kanë qenë të suksesshme dhe e kanë sjellë Shqipërinë sot këtu.

Vetëm para pak orësh ka dalë raporti i Bankës Botërore, që vlerëson me nota pozitive Shqipërinë dhe flet për një rritje ekonomike që ridimensionohet, pra ngrihet parashikimi, nga 3,5 në 4%. “Janë të mirëpritura konsolidimi fiskal, reformat që janë ndërmarrë dhe besueshmëria e financave publike shqiptare”, thotë raporti. Të gjitha këto fjalë të mira, në fund të ditës, përkthehen në para për qytetarët shqiptarë. Pra,

në qoftë se duke dalë dje në tregjet ndërkombëtare kemi treguar besueshmërinë tonë, kjo do të thotë që ne kursejmë, pra nesër mund të investojmë më shumë në shkolla, në spitale, në rrugë. 11 milionë euro të përfituara në vit vetëm nga ndryshimi i normës së interesit! Pra, këto nuk janë operacione financiare të kryera në ajër dhe që nuk kanë efekt për publikun. Këto të gjitha kanë efekt për publikun. Prandaj, këto duhet të jenë një shtysë më shumë, për të kuptuar se çfarë do të thotë kur qeveria ka një sjellje të qartë politike, kur qeveria nuk ndryshon rrugën, kur një maxhorancë politike është e pacenuar nga efekti i votës që mund të ndryshojë ligjet, kur maxhoranca është e përkushtuar ndaj reformave.

Tri gjëra kryesore tregoi ky operacion financiar, që, në fakt, ishte testi i vërtetë i tregjeve.

Më vjen keq që sot në krahun e djathtë mungon forca e ashtuquajtur e djathta e fuqisë së tregut, që thotë se performanca e një vendi apo vlerësimi i ekonomisë, matet vetëm në tregje dhe nuk matet as me fjalime, as nga maxhoranca, as nga opozita. Dhe ajo që pamë në tregje, është që institucione financiare, vende të nderuara, që kanë shekuj që investojnë në bursa, fonde të mëdha si të Norvegjisë dhe Finlandës, marrin pensionet e qytetarëve të tyre dhe i besojnë në një ekonomi si e Shqipërisë. Ato zakonisht janë fondet më konservatore, investojnë vetëm në vende të sigurt dhe kanë investuar në Shqipëri. Besueshmëria e Shqipërisë në tregje fton jo vetëm këto fonde, por nesër do të ftojë edhe kompanitë e mëdha, të cilat patjetër që do të shikojnë normën e interesit, do të shikojnë besueshmërinë në tregje, për t'u afruar dhe për të bërë investime strategjike në Shqipëri.

E dyta, përfitimi i kostove të ulëta të efektivitetit të menaxhimit të borxhit publik. Borxhi publik nuk është një re që rri në ajër, nuk është as edhe ndonjë forcë graviteti si ajo që shikojmë nëpër filma, që nuk ka lidhje me realitetin apo një vrimë e zezë, por është një kosto ekonomike dhe financiare, që vetëm me këtë operacion, fal një pune shumë të gjatë dhe të merituar të qeverisë shqiptare, ka arritur të përfitojë nga 2015-a, në krahasim me qeverinë e parë “Rama”, një kursim prej 11,25 milionë eurosh. Pra, kostot bien duke çuar më shumë para në investimet publike.

E treta, ky operacion financiar ndihmon në mënyrë spektakolare tregjet e brendshme të parasë në Shqipëri. Çfarë ndodh në këtë rast? Në radhë të parë, duke qenë se qeveria këto fonde i ka marrë jashtë tregut shqiptar, kjo bën që të gjitha fondet që janë në tregun shqiptar, kursimet që janë në banka, të mbeten për t'u lëvruar në tregun shqiptar. Pra, bankat që operojnë sot në Shqipëri, këto para do të mund t'ua japin bizneseve shqiptare për të investuar, konsumatorëve shqiptarë familjarë për të blerë më shumë mallra, më shumë shërbime, për të marrë kredi, pse jo edhe për shkollimin e fëmijëve.

Duke lënë më shumë likuiditete në treg, gjithashtu, kjo normë prej 3,5%, normë interesi mbi paranë, vendos një limit, një *benchmark*, që këto banka duhet ta respektojnë në të ardhmen. Pra, nëse më parë qeveria, që është marrësja më e besueshme e kredive në treg, merrte një notë prej 7,5% apo e kishte interesin bazë, interesin më të ulët, 7,5%, atëherë edhe bizneset që do të merrnin kredi, nuk mund të merrnin nën këtë normë, sepse asnjë biznes nuk është më i besueshëm dhe më i sigurt se investimi në bondet apo në eurobondet e një qeverie.

Nga nesër, në treg, bizneset shqiptare kanë avantazh një normë interesi të pandryshuar deri në momentin kur do të dalë edhe një herë në treg. Minimalisht, për vitet që do të vijnë, 3,5% do të jetë norma bazë nga ku duhet të fillojnë dhe të bëjnë llogaritë edhe bankat shqiptare, kur i japin biznesit shqiptar kredi. Kjo e ndihmon shumë biznesin shqiptar, është një frymëmarrje financiare dhe janë më shumë para në treg për t'u lëvruar. I vetmi problem që mund të kemi, që ne po e hasim gjithnjë e më shumë, është stabiliteti politik i një minorance, i një opozite, e cila e kupton që me garë dhe demokraci (siç ka dhënë mesazhin lideri i tyre historik, Berisha) nuk fiton dot me votë. Sot Berisha ka frikë nga vota. Ata do të përpiqen gjithmonë të bllokojnë, të bojkotojnë parlamentin: "marrëdhënie e kushtëzuar". Çfarë do të thotë kjo në demokraci? Ose jeni në parlament, ose nuk jeni; ose do të lindë fëmija, ose nuk do të lindë fëmija.

Këto "jemi, por e kemi të kushtëzuar" nuk janë sjellje normale dhe, në radhë të parë, dëmtojnë demokracinë shqiptare, dëmtojnë edhe shumë tregje dhe biznese shqiptare.

(Bie gongu)

Prandaj i bëj thirrje opozitës që të fillojë të sillet si e rritur, në të mirë të shqiptarëve dhe të bizneseve shqiptare. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bushati!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë".

Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me KfW Frankfurt am Majn për financimin e programit "Fondi i investimeve sociale IV". Ky projektligji është nismë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Nuk e di, a kanë kolegët pyetje për projektligjin?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Nuk kanë.

Atëherë, në bazë të Rregullores, vazhdojmë me diskutimin e tij.

Në listën e diskutantëve për këtë projektligji janë regjistruar deputetët: Klotilda Bushka dhe Adelina Rista, ndërsa në emër të grupit parlamentar të PS-së deputetja Antoneta Dhima.

Fjalën e ka deputetja Bushka.

Klotilda Bushka – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji që kemi në këtë seancë për shqyrtim, për diskutim, ka të bëjë me ndryshimin e një marrëveshjeje ndërmjet Fondit KfW (fonde të qeverisë gjermane) dhe qeverisë shqiptare për sa u takon investimeve në zonat rurale. Projektligji ka të bëjë kryesisht me përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë në fshatrat në Veri të vendit, siç janë ato të Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Veprat kanë të bëjnë kryesisht me rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin nga e para të ujësjellësve, të veprave të kanalizimit, si dhe të rrjetit rrugor rural.

Kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme. Në fakt, arsyeja pse dua të ndalem pikërisht te rëndësia e këtyre lloj investimeve, të cilat i shërbejnë jo vetëm rritjes ekonomike, por edhe mirëqenies në fshatrat tanë, ka të bëjë pikërisht me faktin se vëmendja e kësaj

maxhorance është në çdo cep të Shqipërisë, madje është shtuar dukshëm gjatë gjithë mandatit qeverisës së kësaj maxhorance vëmendja për zonat rurale, pasi ne jemi votuar për t'u shërbyer të gjithë qytetarëve të këtij vendi. Ne jemi votuar për t'i parë rezultatet kryesisht në familjet tona në çdo cep të Shqipërisë. Janë pikërisht qytetarët ata që gjykojnë çdo ditë punën e kësaj maxhorance.

Në fakt, qytetarët janë ata që kanë sy dhe shohin, kanë veshë dhe dëgjojnë. Janë pikërisht ata gjyqtarët tanë më të mirë, sepse ne duhet të na gjykojnë vetëm për punën dhe për premtimet tona, nëse i kemi mbajtur ose jo.

Sot qytetarët kërkojnë mirëqenie, siguri dhe drejtësi. Ne kemi rritur pagat në arsim, në shëndetësi; kemi rritur pagat për ushtarakët dhe do të vazhdojmë t'i rritim këto paga. Është punuar për konsolidimin e financave të shtetit për të pasur një rritje edhe më të madhe ekonomike. Vetëm rezultatet e fundit, të tremujorit të sapokaluar, tregojnë një rritje ekonomike të Shqipërisë në vlerën 4,39%. Por çfarë do të thotë kjo për qytetarët? Jo të gjithë jemi ekonomistë dhe jo të gjithë e kuptojmë se çfarë do të thotë rritje ekonomike. Kjo tregon se në financat e shtetit ka më shumë para të mbledhura nga puna e përgjegjshme e kësaj qeverie, para të cilat kanë shkuar për më shumë investime, kanë shkuar për më shumë vende pune, si rrjedhim, kanë shkuar në xhepat e shqiptarëve, të cilët i kanë konsumuar më shumë në jetën e tyre të përditshme, pra ka pasur një rritje të të ardhurave për frymë. Kemi bërë shumë, por kemi ende shumë për të bërë, madje jemi shumë të ndërgjegjshëm për këtë.

Fakti se ekonomia shqiptare është sot në rritje, më e konsoliduar se më parë dhe më e besueshme në Ballkan, tashmë vërtetohet edhe nga rasti më i fundit i suksesshëm i eurobondit, ku morëm interesin më të ulët historik. Jemi ekonomia më e besueshme në rajon, e thënë kjo nga institucionet ndërkombëtare.

Kemi pasur rritje shumë të lartë të eksporteve; kemi pasur rritje në sektorin e turizmit; kemi pasur rritje në sektorin e bujqësisë; kemi pasur 243 mijë vende pune; kemi pasur lehtësi fiskale, që kanë ndikuar në përmirësimin e ndjeshëm të të ardhurave të biznesit të vogël. Kemi pasur investime në kanalizime, në ujësjellës, në agroturizëm, që

kanë ardhur si rezultat i reformave tona transformuese dhe i kanë treguesit shumë të qartë: me statistika e shifra. Pra, jo me fjalë, por me punë.

Sigurisht, të gjitha programet tona për sa u takon agroturizmit, lehtësirave fiskale, projektit të madh kombëtar për regjistrimin e titujve të tokës bujqësore në këtë vend, si dhe gjithçkaje tjetër që jemi duke bërë, janë tregues të qartë se rritja ekonomike e këtij vendi po shkon si një përfitim në xhepat e qytetarëve dhe të familjeve shqiptare.

Paketa sociale për të pamundurit, formalizimi i ndihmës ekonomike, që ndihma të shkojë atje ku ka nevojë dhe jo në xhepat e militantëve të partisë, i gërshetuar me politikën tona të punësimit, krijon mundësinë që të mos vegjetojnë ato? që janë të pamundur e të marrin para sa për një kore bukë nga shteti, por të kenë një punë dhe të jetojnë me dinjitet.

Çeku i bebeve apo paketa e solidaritetit për pensionistët, rritja e pensioneve dhe ndihma për pensionistët, a nuk janë edhe këta tregues pune që kjo maxhorancë është duke konsoliduar financat e shtetit, duke ndikuar në rritjen e ekonomisë shqiptare dhe, si pasojë, në mirëqenien e familjeve tona?

Më në fund, reforma në drejtësi, që është nëna e të gjitha reformave që ka ndërmarrë kjo maxhorancë dhe që ka vendosur ta çojë deri në fund, është reforma, e cila jo vetëm do t'u japë shqiptarëve një drejtësi të pavarur dhe të pandikueshme nga cilido aktor, politik ose jo, por është edhe reforma, e cila do t'i bëjë të përgjegjshëm të gjithë politikanët në këtë vend, që paratë e shqiptarëve të shkojnë në të mirë të tyre dhe askush të mos guxojë të abuzojë me këto fonde, por ekonomia shqiptare të rritet dhe të shpërndahet njësoj në të gjitha kategoritë e popullsisë sonë.

Kolegët e opozitës nuk do të jenë në sallë. E shoh që ata kanë filluar pushimet dhe nuk kanë ndër mend të merren më me interesat e qytetarëve. Këta kolegë, të cilët nuk kanë më asnjë nismë e asnjë strategji, për të larë mëkatet dhe kusuret që kanë shkaktuar ndaj këtij vendi për kaq shumë vite, duan t'u heqin vëmendjen njerëzve nga rezultatet dhe nga puna e kësaj maxhorance duke vendosur lloj-lloj perdeshe të shëmtuara, të ngritura me gjuhën e urrejtjes dhe

shpifjeve, por, siç thotë populli, “Fshati që duket nuk do kallauz”.

Këta kolegë opozitarë nuk na mundin dot as me punë, as me rezultate, as me inteligjencë, as duke fituar besimin e popullit. Për këtë arsye ata kanë zgjedhur të përdorin gjuhën e intrigës, të urrejtjes, të shpifjes dhe të përbaltjes, por në këtë vend janë qytetarët ata që, siç e thashë, do të na gjykojnë në fund për punën dhe nuk do të ketë më perde që t’i pengojë qytetarët e këtij vendi të shohin realisht se si është duke ecur përpara Shqipëria.

Kemi ende shumë punë për të bërë, ndaj i nkurajoj të gjithë kolegët e mi të maxhorancës, të vazhdojnë të veprojnë siç kanë bërë deri më sot, që ta kenë vëmendjen të përqendruar te njerëzit e këtij vendi, te përgjegjshmëria dhe te puna konkrete me rezultate, që u japin mirëqenie qytetarëve shqiptarë, të cilët na kanë votuar dhe na kanë dhënë besimin që ky vend të bëhet më i mirë, ashtu siç i takon këtij populli.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka deputetja Rista!

Adelina Rista – E nderuar drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë synon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit “Fondi i investimeve sociale IV” për shtyrjen deri më 30 tetor 2018 të afatit të fundit për disbursimin e fondeve për financimin e këtij projekti, si dhe zëvendësimin kudo në tekst të emërimit “Ministria e Financave” me emërtimin “Ministria e Financave dhe e Ekonomisë”.

Ndryshimi i propozuar i kësaj marrëveshjeje konsiston vetëm në shtyrjen e afatit të kredisë së akorduar për projektin në fjalë dhe nuk përbën ndonjë ndryshim në shumën apo në termat e tjera financiare të kredisë. Ky është një projektligj, që nuk shoqërohet me efekte financiare.

Kolegia parafolëse foli për këtë projektligj dhe unë nuk dua ta përsëris, por dua t’ju ftoj të gjithëve ta votojmë njëzëri këtë projektligj.

Kolegë deputetë,

Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe minimizimi i problemeve sociale janë në fokusin e kësaj qeverie. Çeku i bebes, paketa e

rritjes së pagave, paketa e solidaritetit për pensionistët, ulja e taksës për biznesin e vogël, librat falas për nxënësit e klasave të para deri në të katërtën, si dhe librat falas për fëmijët e kategorive në nevojë, ku përfitojnë 190 mijë fëmijë në të gjithë Shqipërinë, paketat e ndihmës ekonomike, politikat e punësimit, janë të gjitha në fokusin e kësaj qeverie dhe i shërbejnë pikërisht rritjes ekonomike dhe shërbimeve për qytetarin.

Si rregull, ne deputetët duhet të qëndrojmë te projektligji në fjalë, por unë ju ftoja pak më parë ta votojmë njëzëri këtë projektligj.

Fjalën time do t’ia kushtoj një çështjeje jo me pak rëndësi, por që meriton vëmendjen maksimale për zhurmën që shkaktoi për ditë me radhë e që edhe sot e kësaj dite nuk është shuar.

Një dramë personale midis dy të rinjsh u bë subjekt për thurjen e një komedie sa të ulët, aq edhe të turpshme politike. Të gjithë kemi qenë dhe jemi dëshmitarë se si personazh i kësaj komedie u bë një vajzë 25-vjeçare, e cila u masakrua pa mëshirë. Unë nuk do t’ia përmend emrin, sepse askush nuk ia tha saktë emrin gjatë gjithë kësaj periudhe.

Unë nuk do të merrem as me deklaratimet, as me kundërdeklarimet e saj. Absolutisht jo, aq më shumë, që kjo çështje është sot në duart e organeve kompetente. Unë do ta përqendroj vëmendjen time pikërisht te dhuna në emër të dhunës, te dhuna psikologjike në emër të luftës ndaj dhunës fizike. Paradoks. Dhunë kundër dhunës!

A mendoi për këtë vajzë ndonjëri nga ata që ulëritën me të madhe, duke përdhosur emrin e saj, duke protestuar me ulërimë? Askush nuk e mori mundimin të trokiste në derën e saj dhe të shihte se çfarë ndjente dhe çfarë përjetonte ajo vajzë dhe familja e saj.

Të gjithë e pamë të dërrmuar psikologjikisht dhe moralisht atë vajzë në daljet e saj televizive. Ajo përpiquej të fshihte sadopak gjendjen e saj shpirtërore, nën një presion të vazhdueshëm, e gatshme të pranonte gjithçka, vetëm e vetëm për të shpëtuar nga tmerrri që nuk po mbaronte. Ajo reflektoi një gjendje të shqetësuar nga dalja e detyruar në TV, duke dashur të shpëtonte nga ky tmerr pa fund.

Unë jam e bindur se të gjithë pas ekranit, nuk po mendonin për vuajtjet dhe për përjetimet e vajzës. Askush nuk mendoi për qetësinë e saj,

askush nuk mendoi për nënën e saj, e cila i rriti ato dy vajza jetime me 1000 sakrifica.

Askush nuk mendoi për këto dy vajza, të rritura jetime, me mungesën e babait të vrarë në një vit të mbrapshtë, të cilave u duhet ta përballojnë me vështirësi jetesën.

Mediet menduan për audiencën, ndërsa miopët politikë menduan për përfitimet e tyre politike, paçka se rruga që kanë gjetur për kredon e tyre, godet shpirtrat e vrarë.

Nuk mbeti kush pa u përfshirë në këtë histori. Me një histeri të shfrenuar kjo histori u hodh në treg për konsum politik me një qëllim të caktuar: e lidhën historinë e saj me politikën. Histeria politike, çjerrja e qarja me lot krokodili nuk kishte aspak lidhje me vajzën. Emri i saj u përdor në kundërshtim me kodin etik të ruajtjes së të dhënave personale. U hodh në treg pa asnjë mëshirë vetëm e vetëm për interes politik. Ajo u përdor për kauzë në mungesë të kauzës. U përdor për kauzë për ata që nuk gjejnë dot kauzë.

Po vajzën kush e mbrojti? Ajo duhej të mbronte me thonj vetveten nga braktisja e “një heroi” në arrati, i cili, në vend që të bënte detyrën, e la në vetmi, duke qenë ai i pari që do të përfitonte nga kjo histori. Gazetarët e terrenit duhej, së paku, të kishin bërë detyrën. Ku ishin shoqatat e shumta, që rendnin për të marrë financime për projektet e tyre kudo dhe kurdo, psikologët e të tjerë? Ku e lanë vajzën? E lanë vetëm.

Ndërsa vendi u soll në rrokopujë medietike dhe politike për disa ditë me radhë, opozita gjeti çelësin kundër qeverisë, që gjoja mbron dhunuesit, duke lëshuar ulërimën për revolucion dhe përmbysje me dhunë. Çfarë tragjedie për këtë opozitë të rrëmuishme, që braktis tempullin e fjalës së lirë për të krijuar anarki, madje, kur është në sallë, bllokun dhe uzurpon foltoren pikërisht për të krijuar anarki!

Historia e këtyre dy të rinjve, e përdorur për konsum politik nga këta politikanë dritëshkurtër, nga gazetarë, që rendin për të kapur lajmin, nga aktivistë civilë, që nuk i kanë haberin se çfarë po ndodh, u luajt si komedi. Kjo komedi u luajt pa të keq mbi jetën e tyre, sikur të ishte gjëja më pavlerë që ekziston. Pra, kjo vajzë nuk është gjë tjetër veçse viktima e radhës, ashtu si shumë vajza dhe gra të tjera, mbi të cilat janë përdorur të gjitha llojet e dhunës, fizike, verbale, psikologjike apo deri në marrjen e jetës. Ato

kanë mbetur thjesht viktima të dhunës në luftën e tyre për të fituar lirinë, për lirinë e jetës, që ta jetojnë ashtu siç e dëshirojnë, sepse ajo vjen vetëm një herë.

Kolegë deputetë,

Secili prej nesh në sjelljen e tij, në komunikimin e tij, në marrëdhëniet që vendos me të tjerët reflekton një kulturë të caktuar.

Ne jemi në fund të vitit 2018, në prag të mbylljes së vitit të 28-të të epokës kur shqiptarët shpërthyen vargonjtë e shoqërisë totalitariste, që përcaktonte normat e sjelljes dhe të moralit. Pra, nga shoqëri e mbyllur, ku mungonte liria, kaluam në një shoqëri të hapur, ku baza është pikërisht liria.

Kjo liri është në luftë të përditshme me moralin e imponuar të së shkuarës; është në luftë të përditshme me civilizimin; është në luftë të përditshme me qytetërimin dhe qytetarinë; është një luftë e fortë ndërmjet së shkuarës dhe të ardhmes. Ashtu si çdo luftë, edhe kjo luftë ka viktimat dhe dëshmorët e saj, duke lënë mënjanë motivin kryesor: shoqërinë maskiliste shqiptare, patriarkalizmin, që mbizotëron nga thellësia e shekujve, ku gruaja shihet si pronë dhe me forcën e dhunës mund të bësh çfarë të duash.

Të vjen vërtet keq kur viktimat e luftës të së shkuarës gjenden te brezit i ri i studentëve, gjenden midis atyre, të cilët do të kenë në dorë të ardhmen e këtij vendi. Kjo është për të ardhur keq, por është e vërtetë.

Brezi i pas viteve ‘90 është brezi i lindur dhe i rritur në demokracinë e kuptuar së prapthi nga shqiptarët; është brezi i lindur dhe i rritur gjatë lëvizjes së lirë të njerëzve, në kërkim të një jete të hapur, por që mjerisht vazhdon të jetojë në një shoqëri të mbyllur, ku mendësia provinciale mbizotëron mbi qytetarinë; është brezi i lindur dhe i rritur në vitet kur anarkia totale kaploi shoqërinë, ku shumë, që e njohin shtetin, presin të zbatohet ligji dhe të marrin atë që u takon dhe të tjerë, që nuk e njohin dhe nuk duan ta njohin, rrëmbejnë çfarë t’u dalë para, paçka se nuk u takon; është brezi që për këngë djepi kishin krismat e armëve, pas vitit të mbrapsht ‘97; është brezi që u rrit me armë nën jastëk dhe u kujdes ta mbajë pastër që të mos ndryshkej pa e shkrepur; është brezi që u rrit me lajmet e kronikës së zezë në vend të parë, të rrëmbimit të jetës së tjetrit për një fjalë goje, për një rrip toke, për një vijë uji, për hesape të vjetra, të shkundura nga pluhuri i

kohës, që nuk i harroi, për hesape të reja të lindura në çast, për çdo gjë dhe për hiçgjë, për një shikim shtrembër dhe pse jo për një vajzë që “ose duhet të jetë imja, ose e askujt; është brezi i lindur dhe i rritur me lajme të përditshme, sepse në plan të parë është audienca e medieve për dhunë verbale dhe fizike të përdorur mbi nënën, vajzën, gruan dhe motrën; është brezi që ka parë modelin më të keq opozitar në sallën e këtij parlamenti, modelin e dhunshëm të kësaj opozite.

Pra, kjo vajzë si çdokush i lindur dhe i rritur në Shqipëri, është pjesë e një shoqërie, ku ende femra, me çfarëdolloj statusi qoftë ajo, nënë, gjyshe, grua, vajzë, motër, kunatë, e fejuar, e dashur apo bashkëjetuese, konsiderohet pronë me pronar mashkullin. Meshkujve të tillë u mungon forca e arsyes, prandaj përdorin forcën fizike, forcën e zakonit të trashëguar nga thellësia e shekujve, përdorin pa të keq dhunën ndaj femrës.

Sot kjo dukuri nuk po na çudit. Në rrugëtimin e saj pas viteve '90 ajo ka marrë dhe po merr jetë të pafajshme, nën trysinë e mentalitetit mbytës të së shkuarës, duke përcjellë ndër breza traditën familjare të mentalitetit të shoqërisë, të gjendjes së vështirë ekonomike, të nivelit të ulët kulturor, të paragjykitimit ndaj femrës për vendin ku banon, për fisin, për shoqërinë dhe faktorë të tjerë. Të gjitha, në kompleksitetin e tyre, kanë të bëjnë me mungesën e një edukimi qytetar dhe të një bashkëjetese qytetare.

Betejën për lirinë dhe për të shpëtuar nga thonjtë skllavërues të pronësisë vajzat shqiptare nuk e kanë aspak të lehtë. Shoqëria shqiptare ka probleme të mëdha në drejtim të bashkëjetesës së mendësisë qytetare me mendësinë provinciale; ka probleme të mëdha në luftën për triumfin e një kulture mbi tjetrën; ka probleme të mëdha në luftën për civilizim.

Qeveria “Rama” i ka në fokus të saj problemet sociale, duke përmirësuar legjislacionin në funksion të tyre dhe në funksion të shërbimeve sociale. Përmirësimi i legjislacionit shqiptar në funksion të barazisë gjinore, së bashku me ligjin “Për strehimit social”, me ligjin “Për ndihmën juridike”, me programet sektoriale, që kanë në fokus barazinë gjinore, me përmirësimin e standardeve të shërbimit ndaj viktimave të dhunës, me Qendrën

Kombëtare për Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës, me linjën kombëtare të këshillimit të vajzave, me strehët sociale e të tjera, me ligjin “Për policimin në komunitet”, me rezolutën kundër dhunës, që është gjithëpërfshirëse, janë në funksion të parandalimit dhe të reduktimit të rasteve të dhunës ndaj femrës dhe dhunës në marrëdhëniet familjare.

A denoncohen dhe a referohen të gjitha rastet e dhunës në familje? A denoncohen dhe a referohen të gjitha rastet e dhunës ndaj femrës? Parë në këtë këndvështrim, mendoj se kemi shumë për të bërë në drejtim të fuqizimit të mekanizmave ekzistues dhe ngritjes së mekanizmave të luftës kundër dhunës, ku ato mungojnë, si dhe në drejtim të mirëfunksionimit të sistemit të referimit dhe shtimit të qendrave të këshillimit, qendrave të rehabilitimit dhe strehëve sociale.

Kolegë deputetë,

A mundemi ne, me mekanizmat ligjorë që kemi, ta parandalojmë dhunën, çfarëdolloji qoftë ajo? Çfarë ndodh me familjet ku dhuna është prezente? Çfarë ndodh me fëmijët, të cilët rriten me dhunë fizike apo psikologjike? Ne flasim shpesh për emancipimin e femrës, flasim shpesh për barazi gjinore, por kjo nuk mund të arrihet pa emancipimin e të gjithë shoqërisë. Prandaj më duhet ta theksoj fort: ne kemi nevojë urgjente për përfshirjen e të gjithë shoqërisë shqiptare në një aksion mbarëkombëtarë emancipimi.

Ne kemi nevojë për programe të ndryshme, që kanë të bëjnë, me edukimin që në moshë të hershme; për programe edukimi që kanë të bëjnë me sistemin e krijimit të vlerave dhe referimit të vlerave tona, që na identifikojnë si komb; për programe edukimi që kanë të bëjnë me sistemin e promovimit të modeleve më të mira njerëzore, për modele të suksesit, që ia kanë dalë të bëhen të suksesshëm vetëm nëpërmjet talentit dhe punës së palodhur dhe asaj çka prodhojnë dhe çfarë bëjnë për familjen dhe shoqërinë.

Duke e përqendruar vëmendjen tek edukimi që në moshën e hershme, në luftën për emancipim bashkë me mjetet e tjera ligjore dhe sistemin e së drejtës, unë besoj fort se shoqëria shqiptare gradualisht do të arrijë ta minimizojë dhunën deri sa të shpëputet nga vargonjtë e së shkuarës së një shoqërie që prodhon dhe gjeneron dhunë.

Ne si shoqëri jemi në një luftë, ku janë shumë beteja për t'u fituar dhe unë besoj se do t'i fitojmë. Jemi në luftë për të fituar betejën e kulturave, civilizimeve dhe qytetërimeve mes së shkuarës dhe së ardhmes, për të ecur drejt qytetërimit perëndimor dhe Europës si qytetarë dinjitozë të një shoqërie të hapur.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Rista!

Me gjithë respektin që kam për ju, si një deputete aktive dhe që adresoni çështjet sociale, më lejon t'ju tërheq vëmendjen, sikurse edhe Kryetari i Kuvendit u tërhoqi vëmendjen diskutuesve të tjerë, sepse nuk folët për çështjen që është në rendin e ditës. Ne po diskutojmë marrëveshjen e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së. Për çështjen, që ju me shumë të drejtë e ngritët, lidhur me trajtimin e zonjës që ishte viktimë, do t'ju lutesha t'i referoheni nenit 45 të Rregullores, i cili i lejon deputetët të flasin për çështjet jashtë rendit të ditës. Gjithashtu, është edhe një mundësi tjetër sipas nenit 46 "Diskutimet në seancë", ku çdo deputet që dëshiron të diskutojë një çështje të përfshirë ose jo në rendin e ditës, e kërkon atë duke u regjistruar paraprakisht. Prandaj herën tjetër, që të mos ju ndërpritet fjala, respektoni agjendën, rendin e ditës dhe flisni për projektligjin që është duke u diskutuar.

Faleminderit për mirëkuptimin!

Këtu përfundon edhe lista e personave të regjistruar për diskutimin e kësaj marrëveshjeje.

Kalojmë në diskutimet në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

Antoneta Dhima – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të dashur qytetarë,

Jemi në momentin kur Shqipëria ka kaluar shumë rrugë të pashkelura, falë reformave të mëdha që janë bërë në këtë vend gjatë mandatit të parë qeverisës dhe në vijim të këtij mandati të dytë të kësaj maxhorance.

Të gjithë jemi të bindur se e ardhmja e shqiptarëve do të jetë shumë herë më e mirë, por për këtë, së pari, ne si deputetë duhet të jemi në lartësinë e detyrës. E gjithë vëmendja duhet të jetë për qytetarët për të dhënë llogari në prag të zgjedhjeve lokale.

Reforma në drejtësi duhet të shërbejë si një nga nismat më të mira për vendin. Ajo po ecën me ritme të kënaqshme, pavarësisht bojkotit të opozitës. Do të ishte shumë mirë që opozita në vend të bojkotit të ishte prezente dhe të votonte organet e reja të drejtësisë: SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit. Mes nesh nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë që do të vendosë shkopinë në rrota, për ta bërë të pazbatueshme reformën në drejtësi. Te maxhoranca nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë individ që të mos respektojë institucionet dhe drejtësinë, ashtu sikurse edhe në radhët e opozitës nuk duhet të ketë individë të tillë.

Më bën përshtypje dhe nuk ka se si të mos ndihem keq kur çdo ditë ballafaqohem me akuzat e opozitës, që më shumë se akuza janë hedhje balte mbi cilindo që nuk ka të njëjtën bindje politike me të.

Ka ardhur koha që për çdo akuzë të ketë fakte dhe prova dhe në çdo rast të jetë drejtësia ajo që duhet të vendosë. Nuk mund dhe nuk duhet të shfrytëzohet asnjë seli e partive politike, qoftë ajo blu, e verdhë, e kuqe apo jeshile, që të përballlet me cilindo nga ne. Kjo ka ndodhur në shumë vite tranzicioni të këtij vendi, por koha duhet të tregojë të kundërtën. Shqiptarët kanë humbur dhe kanë arritur shumë në këto 28 vjet të pluralizmit, por shumë e më shumë do të kishte ecur Shqipëria, nëse klasa politike do të kishte më shumë integritet dhe dinjitet, për të mos akuzuar pa asnjë fakt dhe provë cilindo.

Koha punon për të ardhmen, për fëmijët tanë, por edhe për fëmijët e kolegëve demokratë që zgjedhin bojkotin dhe jo seancën plenare. Besoj se do të ishte shumë më mirë që diskutimet e sotme të bëheshin nga të dyja palët.

Opozita ka ngecur te vetingu në politikë. Unë mendoj që në propozimin e saj ka shumë të çara politike, juridike dhe morale, që fusin ujë dhe këtu ndaj të njëjtin mendim me kritikët, që nga mungesa e sinqeritetit dhe deri te absurdi që kanë prodhuar dhe përsëriten në kor, me parimin që budallallëku ngjan pa përsëritet. Prandaj sot më shumë se kurrë, opozita duhet të gjejë rrugën e saj, të cilën e ka humbur që prej vitit 2013.

Le të shërbejë kjo fjalë si një apel modest për çdo opozitar në këtë vend, që të rikthehet kultura e debatit dhe e dialogut aty ku është vendi për debat dhe për dialog. Nuk besoj dhe as mendoj që mund të ketë debate dhe dialog në

distancë, në rrugë apo në salla hotelesh pikërisht në ditët kur parlamenti mbledhet në seanca plenare. Së bashku duhet të diskutojmë, për çfarë? Për arritjet e kësaj qeverie, për treguesit ekonomiko-financiarë, për rritjen ekonomike, për konsumin, për papunësinë, për borxhin publik, për deficitin buxhetor, për arsimin, për shëndetësinë, për ushtrinë, për turizmin, për kulturën dhe për të gjithë sektorët e ekonomisë. Së bashku duhet të diskutojmë për të gjitha problemet dhe problematikat që shqetësojnë sot vendin. Emocionet politike nuk i zhbëjnë dot reformat e realizuara dhe të ndërmarra nga ana e kësaj qeverie, as zhvillimin ekonomik, as punën e përditshme në shërbim të përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe bizneseve. Së shpejti, me buxhetin e vitit 2019 dhe me paketën fiskale, të tjera lajme të mira dhe lehtësira të rëndësishme do të kemi për t'i prezantuar në këtë seancë plenare.

Projektligji që po diskutojmë sot synon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit lidhur mes Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”.

Ndryshimi i marrëveshjes së huas dhe i programit të financimit të projektit “Fondi i investimeve sociale IV” konsiston në ndryshimin e nenit 3/2 të marrëveshjes, në të cilin përfaqësohet afati i fundit i disbursimit në kuadër të kësaj marrëveshjeje, duke e shtyrë deri në datën 30 tetor 2018, si dhe një zëvendësim i emërimit “Ministria e Financave”, e cila në të gjithë tekstin do të jetë “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”.

Në fakt, punimet civile për të shtata objektet ose për 94 kilometra rrugë kanë përfunduar, si dhe janë kryer të gjitha pagesat bashkë me garancinë e defekteve. Të gjitha objektet pas përfundimit të periudhës së garancisë janë dorëzuar pranë njësive të qeverisjes vendore, po ashtu supervisorit i punimeve ka përfunduar raportin final, i cili është dërguar pranë KfW-së. Duke iu referuar kontratës së supervisorit pagesa përfundimtare e garancisë me vlerën 5% të kontratës, do të kryhej në fund të periudhës së garancisë së punimeve apo në dhjetor 2017. Kjo periudhë shkonte përtej

afatit të disbursimit të fondeve të huas, i cili ka përfunduar në qershor të vitit 2017. Në këto kushte, u dakordësua me KfW-në shtyrja e afateve të marrëveshjes në mënyrë që të ekzekutohet edhe pagesa e fundit.

Ky program në fokus të tij ka pasur dy komponentë kryesorë dhe shumë të rëndësishëm: rehabilitimin e rrugëve rurale dhe ndërtimin e skemave të ujësjellësve ruralë.

Sa i takon komponentit të rrugëve rurale, KfW-ja dhe IPA 2009 e kanë bashkëfinancuar këtë program përkatësisht me 15 dhe 8,8 milionë euro, me kontribut lokal 0,6 milionë euro. Në marrëveshjen e financimit është vendosur që fondet e këtyre donatorëve të menaxhohen si një i vetëm. Me këto fonde u financuan rreth 90 kilometra rrugë në qarqet e Kukësit, Dibrës dhe Shkodrës. Punimet kanë përfunduar në të gjitha segmentet e financuara dhe rreth 36 mijë banorë kanë përfituar nga ndërtimi i këtyre segmenteve rrugore.

Në kuadër të programit të financuar nga KfW-ja në vlerën 5 milionë euro dhe 0,8 milionë euro të tjera, që janë kontribut lokal nga njësia e qeverisjes vendore, e cila është edhe përfituese e këtij projekti, u ndërtuan 15 skema ujësjellësish në qarqet Kukës, Shkodër dhe Dibër. Pjesë e investimeve është edhe linja e re e transmetimit të Sopanikës në Dibër dhe vendosja e matësve në qytetin e Bajram Currit. Përmes këtij projekti është siguruar furnizimi me ujë higjienisht të pastër për rreth 20 mijë banorë të zonave rurale në 24 fshatra, të cilët janë përqendruar në 11 njësi administrative.

Punimet civile në 15 skemat e ujësjellësve përfunduan gjatë vitit 2015. Referuar marrëveshjes së investimit dhe komponentëve të saj, të ndërhyrjes për masa sanitare emergjente, është ndërhyrë në 9 skema ku ishte investuar për ndërtimin e ujësjellësve. Zbatimi i përmirësimit të infrastrukturës sanitare në skemat e përzgjedhura ka përfunduar në vitin 2016. Gjithashtu, u investua për pajisjen dhe matësat e ujit në qytetin e Bajram Currit, në mënyrë që të menaxhohet konsumi i ujit për skemat që varen nga linja e transmetimit që furnizon këtë qytet me ujë. Punimet për vendosjen e matësve kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2016.

Në kushtet kur ky projektligj i propozuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është në funksion të

rehabilitimit të rrugëve rurale dhe ndërtimit të skemave të ujësjellësve ruralë, të nderuar kolege dhe kolegë deputetë, ju ftoj ta miratojmë!

Në fakt, si deputete e qarkut të Fierit, e inkurajoj qeverinë të angazhohet maksimalisht për zbatimin e **ligjit nr. 8/2017**, datë 02.02.2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë të naftës dhe të gazit”, si dhe kryerjen e pagesës për dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga lëkundjet e tokës në njësinë administrative Zharrëz.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Këtu mbyllet diskutimi në parim për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””.

Të nderuar kolegë, kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës. Bëhet fjalë për 3 projektvendimet, që lidhen me organet që merren me vetingun, konkretisht: projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 93 i vitit 2017 i Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit””, projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 92, i vitit 2017 i Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit””, si dhe projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 94, të vitit 2017 i Kuvendit të Shqipërisë “Për miratimin e strukturës dhe organikës së institucionit të Komisionerit Publik””.

Meqenëse të tria projektvendimet lidhen së bashku dhe kanë të bëjnë me një problematikë të shqyrtuar bashkërisht në Komisionin e Ligjeve, edhe diskutimet për të tria këto projektvendime do të jenë së bashku.

Nuk e di nëse zoti Balla do të diskutojë, apo do të kalojmë direkt në shprehjen në emër të grupit parlamentar?

Fjala për zotin Balla.

Taulant Balla - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Kolegë të pranishëm në sallë,

Në fakt, të tria vendimet e sotme janë shprehja dhe rikonfirmimi më i qartë i faktit se kush e ka bindje, angazhim, seriozitet maksimal vetingun në drejtësi dhe kush erdhi me zor për ta votuar 2 vjet më parë reformën në drejtësi. Këtu është dallimi më i qartë mes nesh dhe të munguarve të sotëm, të cilët, për shkak të javës jashtë Shqipërisë të kryetarit të Partisë Demokratike, nuk kishin sot hotel ku të shkonin, por dy kryetarët e grupeve parlamentare u shpërdoruan nga Lulzimi për diçka, për të cilën do të them dy fjalë më pas.

Po fokusohem tek tri vendimet e sotme, të cilat janë vijimi i mbështetjes së pakufizuar që kjo qeveri dhe kjo maxhorancë i jep procesit të vetingut. Nga të tria institucionet bazë të procesit të vetingut: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ai i Apelimit dhe sigurisht nga Komisionerët Publikë është kërkuar një mbështetje në forcimin e kapaciteteve njerëzore të këtyre institucioneve. Sigurisht, kjo ka një shtesë në faturën publike, që buxheti i shtetit duhet t’u jape. Ne sot po e japim këtë mbështetje me qëllim që këto tri institucione jo vetëm ta vijnë punën me intensitet, por të rrisin shpejtësinë, sepse qytetarët shqiptarë mezi presin që jo vetëm 70 e kusur gjyqtarët e prokurorë që e kanë kaluar këtë proces deri më tani, por edhe ata qindra të tjerë, të cilët presin ta kalojnë këtë proces, të dalin para shqiptarëve dhe të bëhet e qartë se kush e meriton dhe kush nuk e meriton të vijojë të jetë gjyqtar e prokuror. Ajo çfarë kemi parë në këta pak muaj ka konfirmuar qartë se sa e thellë paska qenë sëmundja, kolera e korrupsionit në gjyqësor. Kemi parë gjyqtarë, të cilët nuk e justifikonin me disafish pasurinë, sikurse kemi parë gjyqtarë dhe prokurorë, gjithashtu, të cilët nuk e justifikonin dot të ishin në sistem, sepse kishin dhënë vendime skandaloze, e për më keq, kemi parë raste gjyqtarësh e prokurorësh të lidhur me krimin. Përsëri këtu është dallimi mes atyre që duan të gjejnë alibinë për të ikur nga Kuvendi i Shqipërisë, e pse jo ndoshta për të ikur edhe nga zgjedhjet e ardhshme lokale, sepse e dinë fare mirë që nuk kanë as lidërsip, as ekip dhe as program për t’u përballur.

Sot, halli i opozitës është halli i Lulzim Bashës. Njeriu që nuk i fiton dot zgjedhjet, që

nuk di të drejtojë një parti, jo vetëm që mori më qafë partinë e tij, por edhe partinë e Monikës. Të bashkuar, pa asnjë arsye, sot ata mungojnë për t'i dhënë mbështetje vetingut të drejtësisë. Janë këto tri vendime, të cilat sjellin një ndarje të qartë, të dashur kolegë, mes nesh që e kemi bindje, seriozitet, gatishmëri për ta çuar deri në fund reformën në drejtësi dhe atyre.

Këtu do të doja të bëja një kronologji të gjithë asaj që ndodhi në muajin shtator. Kur ne e filluam këtë sesion, Partia Demokratike kërkoi pazar për të ndryshuar 7 ligjet e vetingut, kurse ne nuk u ofruam, sepse nuk bëhemi kurrë pjesë e një pazari për të ndryshuar ligjet e vetingut, sepse ne nuk do të bëjmë kurrë pazar në kurriz të vetingut në drejtësi. Pra, pasi nuk morën asnjë përgjigje për pazarin e kërkuar, u futën në një diskutim, i cili ka përfunduar që ditën e parë që kemi miratuar reformën në drejtësi, sepse për të gjithë ata shqiptarë, njerëz të thjeshtë dhe të zakonshëm të këtij vendi, më lejoni ta them shumë qartë: reforma në drejtësi ka pasur dhe ka në thelbin e saj objektivin fundor dhe kryesor, atë të vetingut të politikës, por ne kurrsesi nuk kemi pranuar dhe nuk do të pranojmë një veting të politikës pa u hetuar pasuritë e familjarëve, pa u hetuar korrupsioni 27-vjeçar i politikës. Partia Demokratike nuk e do këtë, Partia Demokratike ka sjellë në Kuvend dy faqe letër, me të cilat jo vetëm që ngre një trumbë me ferra para vetingut të drejtësisë, por synon të bllokojë Prokurorinë Speciale Antikorrupsion dhe Byronë Kombëtare të Hetimit.

Në këtë kontekst, më lejoni t'ju them se mjafton të marrim shembullin e një vendi si Rumania, ku Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Njësia Antikorrupsion kanë çuar përpara drejtësisë dhe kanë ndëshkuar 13 ministra, 38 deputetë dhe senatorë. E pra, ky është modeli më i mirë i vetingut të politikës. Nuk bëhet vetingu i politikës duke ndenjur opozita nëpër hotele apo në mungesë të kryetarit të Partisë Demokratike; nuk bëhet vetingu i politikës duke mbajtur nga një fjalim kryetari i opozitës në hotelin e radhës. Thirrja ime është që Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim duhet të jenë sot këtu, për t'i votuar këto tri vendime që çojnë përpara reformën në drejtësi dhe vetingun në drejtësi.

Sa për çështjen tjetër, atë të baltës dhe të shpifjes, sigurisht që ne kemi bindje se nuk bëhet më politikë në vitin 2018 me baltë e me shpifje.

Thirrja ime sot ndaj prokurorisë, edhe për shpifjen më të fundit të serisë së radhës "Babale 2", është të hetojë menjëherë. Mjaft më me muaj për të zbardhur një çështje, që është tërësisht e zbardhshme brenda pak ditësh. Nëse unë, Rahman Rrahja apo Artur Bushi, kemi qenë apo jo atje, ka plot prova për ta vërtetuar, por ama ju garantoj, kolegë deputetë, se kjo histori do të jetë një histori e radhës e turpit të Lulzim Bashës, që shantazhon deputetët dhe kryetarin e grupit parlamentar të shumicës, por unë e garantoj se nuk shantazhohem kurrë. Nuk shantazhohem nga Lulzimi, sepse të të shantazhojë Lulzimi është turp.

Javën e kaluar Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka nxjerrë prova të qarta se Lulzim Basha, duke shfrytëzuar foltoren e Kuvendit ose atë të Partisë Demokratike, ka shantazhuar bizneset në këmbim të parave për kompaninë e kunatit të tij. Si mund të besojnë shqiptarët një njeri, i cili këtej zotohet se do të bëjë vetingun e oligarkëve, ndërkohë që pasdite oligarkëve u merr faturën për kompaninë e kunatit të tij?!

Deputetët e Partisë Socialiste: Bushati, Spiropali dhe Bushka publikuan javën e kaluar fakte konkrete. Unë i kërkoj ministrit të Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të bëhen publike të gjitha këto të dhëna që ne i kemi siguruar. Sigurisht, do t'ua bëjmë publike edhe shqiptarëve sesi ka mundësi që një kompani në dy vjet të njëpasnjëshëm të deklarojë xhiro mbi 2 milionë lekë në vit, por në njërin vit paguan 10% fitim, ndërsa në vitin tjetër paguan 2% fitim? A është evazion fiskal ky? Kjo u takon institucioneve, por ne do ta ndjekim këtë çështje, sepse është e rëndë që kryetari i opozitës shantazhon biznesin në këmbim të përfitimeve. Opozita duhet të jetë gardiane e qeverisë, sot opozita është shantazhuere e sipërmarrjes së lirë të vendit. Kjo është e paimaginueshme.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Këtu mbyllet lista e diskutantëve të regjistruar.

Kalojmë në emër të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste fjalën e ka deputeti Bashkim Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Sot në seancë plenare janë paraqitur për miratim tri projektakte, të cilat kanë të bëjnë me disa shtesa të numrit të punonjësve, si dhe me ndryshimin e organikës dhe klasifikimin e pagave të personelit të tri institucioneve të pavarura kushtetuese, të ngarkuara me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht: të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Komisionerëve Publikë.

Kuvendi i Shqipërisë është organi përgjegjës për të miratuar strukturën organizative, pagat e personelit të institucioneve të rivlerësimit, me propozim të vetë këtyre institucioneve.

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në nenin 18 parashikon që institucionet e rivlerësimit kanë personel dhe pajisje të nevojshme për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga ky ligj.

Gjendemi këtu sot pas një viti nga koha kur Kuvendi i Shqipërisë, pikërisht më 28 shtator të vitit 2017, për herë të parë miratoi strukturën dhe numrin e punonjësve të tri organeve të vetingut, të zgjedhura nga Kuvendi i Shqipërisë më 12 qershor të vitit 2017.

Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjit të posaçëm nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimet nr.92, nr.93 dhe nr.94 të vitit 2017, Kuvendi miratoi numrin e punonjësve për secilin nga këto tri organe dhe konkretisht: 50 punonjës për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit; 37 për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe 26 për Komisionerët Publikë.

Procesi i vetingut, aq i diskutuar nga të gjithë ne, deputetët, kryeministri, ministrat, gazetarët, shoqëria civile, publiku, media, aktorët ndërkombëtarë e të tjerë, në fund të fundit, është shumë i rëndësishëm për shoqërinë shqiptare, sepse do të garantojë funksionimin e duhur të drejtësisë së cunguar ose të munguar dhe do të kthejë besimin për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe vlerave të tij demokratike.

Të gjithë në këtë sallë, pavarësisht përfaqësimit politik, e kemi pranuar këtu në Kuvend, por edhe jashtë tij, se shpejtësia dhe cilësia e punës së tri organeve të vetingut, pavarësia dhe integriteti i komisionerëve të

Pavarur të Kualifikimit, e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm dhe Komisionerëve Publikë janë faktorët kyç për çeljen e negociatave të Shqipërisë për vitin 2019.

Prioriteti i kësaj maxhorance është që reforma në drejtësi të zbatohet pa vonesë edhe me ngritjen e strukturave të tjera, që kanë përcaktuar Kushtetuta dhe ligji i posaçëm, madje ky i fundit, si një proces unik, përbën sfidën kryesore të shtetit shqiptar për çeljen e bisedimeve për anëtarësim.

Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të kësaj maxhorance, ka miratuar në maj të vitit 2018 rezolutën për rekomandimet e Komisionit Europian për hapjen e negociatave midis Bashkimit Europian dhe Shqipërisë. Në këtë rezolutë Kuvendi i Shqipërisë i kërkon qeverisë të thellojë dhe përshejtojë ritmin e reformave të ndërmarra, veçanërisht të reformave që lidhen me sundimin e ligjit. Edhe në planin afatshkurtër të masave të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Europian, adresuar Shqipërisë, në prill të vitit 2018 është kërkuar mbështetja financiare e strukturore e organeve të pavarura me fokus atë të sistemit të drejtësisë.

Nuk mund të lë pa përmendur angazhimin serioz të qeverisë për mbështetjen që u ka dhënë këtyre institucioneve të pavarura kushtetuese që në momentin e krijimit të tyre, me logjistikën e ofruar, me mbështetjen financiare, me akordimin e shtesës për vështirësi pune për anëtarët në masën 50 % të pagës bruto mujore, si dhe në fund të vitit të kaluar, përjashtimisht për tri institucionet e rivlerësimit, ofroi shpërbtim duke dëshmuar për vlerësimin, nxitjen dhe besimin në punën e pavarur të organeve të vetingut.

Të nderuar kolegë, në mënyrë të përmbledhur të tria organet e vetingut kanë paraqitur këto kërkesa pranë Komisionit të Ligjeve:

KPK-ja kërkon 16 punonjës, Komisionerët Publikë 5 punonjës dhe KPA-ja 10 punonjës, sipas strukturës që ata kanë. Ajo që ne diskutuam gjerësisht, për të cilën bëmë disa konsulta, kishte të bënte me këshilltarët ekonomistë, të cilët deri tani kanë qenë më pak se ata juristë, kanë një volum pune të shtuar në dosje, duke parë edhe trendin e verifikimit pasuror.

Në diskutimet paraprahe me përfaqësues të tri organeve, por edhe pas marrjes së mendimit të

Departamentit të Administratës Publike, komisionit iu paraqit nga ana ime si relator që në kuadër të unifikimit, nxitjes dhe trajtimit në mënyrë të padiferencuar të tri organeve të vetingut, të ofrojë një mundësi zgjidhjeje racionale të dobishme për institucionet, duke shtuar sipas pozicioneve të njëjta, që përbëjnë bërthamën e punës këshilluese të komisionerëve, të anëtarëve të Kolegjit, stafin e kërkuar për këshilltarë, si dhe për të shtuar një numër të vogël specialistësh, për të cilët u bënë edhe rishikimet e pagave duke i ngritur në kategori dhe barazuar trajtimin e pagës për specialistët gjyqësorë njësoj me stafin tjetër të tri organeve të vetingut. Gjithashtu, u mor mendimi i Ministrisë së Financave për efektet financiare. Ndërkohë, dua të them që vetë organet kanë fondin e tyre rezervë buxhetor që nuk është përdorur gjatë vitit 2018 dhe i përballojnë ndryshimin dhe shtesat me fondet e papërdorura, ndërkohë që për buxhetin e vitit 2019, që ne do ta kalojmë pas një muaji, kjo organikë është automatikisht e përllogaritur.

Më duhet të theksoj se si relator, por edhe se jam marrë shpesh me kërkesat e institucioneve të ndryshme të pavarura që krijohen rishtazi, por edhe në analizë të kërkesave të argumenteve të këtyre organeve kaq të rëndësishme, vë re se, pas një viti pune të mirëfilltë të tyre, këto organe janë të qarta për funksionet dhe vështirësitë e tyre, bazuar në volumin e punës që kanë, të cilin do ta kenë të shtuar në të ardhmen.

Ne sot si maxhorancë dhe si Kuvend, deputetë të pakicës dhe shumicës, duhet të mbajmë premtimin e bërë para një viti në komisione dhe në seancë plenare që këto organe të fillojnë punën dhe gjatë një viti, mbi bazën e vështirësive, të sjellin kërkesat që ata mendojnë, të cilat do t'i japin një hov procesit për vendimmarrje të ligjshme në kohë, me cilësi, paanshmëri dhe profesionalizëm.

Në përfundim, nga 16 kërkesa, KPK-së ne i kemi miratuar 14, nga 10 kërkesa, KPA-së i janë miratuar 6 dhe nga 5 kërkesat e Komsionerit Publik i janë miratuar 4. Pra, pas një diskutimi që kemi bërë me tri organet e vetingut si komision kemi arritur në këtë konkluzion dhe në projektvendimet që ju keni përpara.

Në tërësi janë miratuar thuajse në masë të gjerë propozimet e institucioneve. Këto mund të duken edhe të fryra në raport me institucionet e

tjera kushtetuese, të krijuara me ligj, duke konsideruar edhe paga, trajtimet dhe shërbimet e veçanta të këtyre institucioneve që përfitojnë, por ne jemi vullnetplotë se duhet të mbështesim punën e tyre që këto organe të mos kenë asnjë pengesë dhe njëkohësisht të ruajnë integritetin dhe pavarësinë në misionin e tyre kaq madhor dhe delikat njëkohësisht.

Për sa më sipër ju ftoj, të nderuar kolegë, t'i miratojmë projektvendimet, duke shprehur se u kemi dhënë organeve të gjithë mundësinë dhe suportin që ato të kenë më shumë mundësi për të shpejtuar procesin e tyre vendimmarrës në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Fino!

Këtu mbyllet diskutimi për tri projektvendimet, kërkesë për një shtesë për personelin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për disa ndryshime në strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe njëkohësisht për shtesë të numrit të punonjësve dhe klasifikim të pagave të administratës së institucionit të Komsionerëve Publikë.

Ju lutem, 5 minuta pushim, dhe deputetët të vijnë në sallë për votim.

(Drejtimitin e seancës e merr zoti Ruçi)

Gramoz Ruçi – Rifillojmë seancën.

Të futet media!

Shërbimi të heqë kartat e deputetëve që s'janë në sallë!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

72 deputetë janë të pranishëm.

Fillojmë me projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë””.

Sipas Kushtetutës dhe Rregullores, ky ligj kërkon për miratim shumicë të thjeshtë votash.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV””.

Ky projektligj kërkon shumicë absolute votash për miratim.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.93/2017 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit””.

Kërkohet shumicë e thjeshtë votash, sipas Kushtetutës dhe Rregullores.

Është vetëm një votim me elektronikë.

Votimi është i hapur.

(Votohet propozimi i Komisionit të Ligjeve.)

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.93/2017 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit””.

Kalojmë te projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr.92/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit””.

Sipas nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Është vetëm një votim me elektronikë.

Votimi është i hapur.

(Votohet propozimi i Komisionit të Ligjeve.)

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendimi “Për disa ndryshime të strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”.

Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.94/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës

dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”.

Sipas nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, edhe ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash.

(Votohet propozimi i Komisionit të Ligjeve.)

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.94/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë”.

Projektvendim “Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Institutit për Studimin e Krimeve të Pasojave të Komunizmit në Shqipëri”.

Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla – Faleminderit, zoti Kryetar!

Bazuar në Rregulloren e Kuvendit, në emër të Grupit Parlamentar të PS-së kërkoj shtyrjen për seancën pasardhëse të këtij vendimi, sepse nuk kemi diskutuar në grupin parlamentar këtë çështje. Bazuar në Rregullore, kërkoj spostimin në seancën pasardhëse për ta votuar këtë projektvendim.

Gramoz Ruçi – Dakord, projektvendimi kalon për votim në seancën tjetër.

Kalojmë në projektvendimin “Për miratimin me procedurës paraprake për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë”.

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Rregullores, edhe ky projektvendim kërkon shumicë të thjeshtë votash. Kemi një votim me elektronikë. Votim i hapur.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

72 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Dy projektligjet e bartura, që kërkojnë shumicë të cilësuar votash, pra 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, projektligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligji “Për një ndryshim në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” nuk mund të votohen pasi nuk është kuorumi i nevojshëm, kështu që barten për seancën pasardhëse.

Këtu përfundon seanca e ditës së sotme.

Faleminderit!

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 12:30.)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

Drejtori i Shërbimit të Botimeve

Parlamentare

Krenar Hajdëri

